



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 458 Akti

Nr. 592 Vendimi  
Tiranë, më 24.11.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 22.11.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Erion Pano**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktualisht këshilltar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (i komanduar).

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Erion Pano, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktualisht këshilltar ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët: Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Firdes Shuli, me cilësinë e kryesueses dhe Brunilda Bekteshi, anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 23.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Francesco Ciardi.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

<sup>1</sup>Raporti dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2018.

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Erion Pano*.

7. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 3.11.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Erion Pano dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Për një proces të rregullt ligjor, z. Erion Pano i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe u njoh me rezultatet paraprake të hetimit administrativ.

11. Z. Erion Pano, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datën 16.11.2022. Subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 18.11.2022.

13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 22.11.2022, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti

<sup>2</sup>Raporti nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.10.2021, të KDZH-së.

<sup>3</sup>Raporti i miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.12.2021, të KLP-së.

i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Subjekti i rivlerësimit Erion Pano ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Z. Erion Pano ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;

**h.** shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Erion Pano, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë/aktualisht këshilltar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

23. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

24. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga z. Erion Pano në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 23.1.2017, në zbatim të ligjit, ku subjekti ka deklaruar:

**25. Apartament<sup>4</sup> me sipërfaqe 83 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 9.8 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “I.T”, Selitë, Tiranë, i blerë me kontratë shitblerjeje datë 5.10.2011, në vlerën 61.000 euro.**

26. Si burim për krijimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar:

- i. huamarrje në shumën 3.000.000 lekë, realizuar me kontratën e huamarrjes nr. \*\*\*, datë 27.9.2011, e cila është shlyer ndër vite dhe e plotë në datën 12.10.2016, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*;
- ii. hua në shumën 10.000 euro, me kontratë huamarrjeje nr. \*\*\*, datë 12.12.2008, e cila i është shlyer huadhënësit ndër vite dhe e plotë sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 12.12.2014;
- iii. bono thesari në shumën 1.900.000 lekë (në emër të z. Erion Pano) në Bankën e Shqipërisë, me burim kursimet e subjektit dhe bashkëshortes nga puna ndër vite, të cilën e ka tërhequr të plotë në datën 19.6.2008;
- iv. bono thesari në shumën 848.947 lekë (në emër të znj. E.P) në Bankën e Shqipërisë me burim kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes nga puna ndër vite, tërhequr në datën 24.2.2011;

---

<sup>4</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentet vijuese: (1) kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\* datë 5.10.2011, me palë shitëse shoqërinë “F-M K” sh.p.k. dhe palë blerëse z. Erion Pano, për blerjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe banimi 83 m<sup>2</sup> në katin e katërt, me nr. pasurie \*\*\*, e ndodhur në z.k. \*\*\*, në adresën: rruga “I.T”, Tiranë, në vlerën 61.000 euro. Bashkëlidhur ndodhet vërtetimi hipotekor nr. \*\*\*, data 21.10.2011, në emër të z. Erion Pano dhe hartë treguese e pasurisë lëshuar në datën 21.10.2011; (2) kontratë huamarrjeje nr. \*\*\*, datë 27.9.2011, me huadhënës N. M dhe huamarrës Erion Pano. Shuma e huas 3.000.000 lekë me afat 27.9.2011 – 27.9.2018, pa interes, e cila është marrë nga pala huamarrëse jashtë zyrës noteriale; (3) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 12.10.2016, ku shtetasi N.M deklaroi shlyerjen e plotë të huas nga Erion Pano; (4) kontratë huamarrjeje nr. \*\*\*, datë 12.12.2008 (me datë të korrigjuar) me huadhënës A.V dhe huamarrës Erion Pano. Shuma e huas është 10.000 euro, pa interes dhe për një afat kohor 2-vjeçar (10.11.2008 – 10.11.2010); (5) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 12.12.2014, përmes së cilës A.V deklaroi shlyerjen totale të huas nga Erion Pano; (6) kartela e klientit Erion Pano, për periudhën 1.1.2006 – 21.10.2016 nga Banka e Shqipërisë, Zyra e Bonove të Thesarit. Tërhequr shuma totale me vlerë nominale 1.900.000 lekë, në datën 19.6.2008; (7) nxjerrje llogarie e z. Erion Pano nga Banka e Shqipërisë për periudhën 1.1.2003 – 1.1.2006; (8) kartela e klientit E. P për periudhën 1.1.2006 - 31.12.2011 nga Zyra e Bonove të Thesarit Banka e Shqipërisë. Tërhequr shuma totale me vlerë nominale 848.947 lekë, në datën 17.2.2011.

- v. interesat e bonove të thesarit, gjendja *cash* në banesë, akumuluar ndër vite nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes.

### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

27. Nga dokumentacioni i ardhur nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug<sup>5</sup> konfirmohet pasuria “apartament” me sip. 83 m<sup>2</sup>, me nr.\*\*\* + \*\*, vol. \*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në Tiranë, në pronësi të z. Erion Pano, blerë përmes kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 5.10.2011, të lidhur me shoqërinë ndërtimore “F-M K” sh.p.k.

28. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Erion Pano ka blerë apartamentin pranë shoqërisë “F-M K” sh.p.k. me kontratën e shitblerjes<sup>6</sup> datë 5.10.2011, në vlerën 61.000 euro, pagesë e cila është kryer jashtë zyrës noteriale. Kjo pasuri është regjistruar në pronësi të subjektit, bazuar në vërtetimin nga dokumentet hipotekore nr. \*\*\*, datë 21.10.2011.

29. Nga dokumentacioni<sup>7</sup> i administruar në dosje ka rezultuar se për blerjen e kësaj pasurie, fillimisht, është nënshkruar një kontratë porosie (për ndërtim dhe dorëzim apartamenti), datë 25.3.2010, midis bashkëshortes së subjektit, znj. E.P, me shoqërinë sipërmarrëse “F-M K” sh.p.k. dhe, më pas, kjo marrëveshje është finalizuar me kontratën e shitblerjes<sup>8</sup> datë 5.10.2011, të lidhur midis subjektit Erion Pano dhe shoqërisë sipërmarrëse.

30. Në kontratën e porosisë, datë 25.3.2010, palët kanë përcaktuar se apartamenti (çelësat) i është dorëzuar porositësit në datën e nënshkrimit të kontratës më 25.3.2010, me qëllim shfrytëzimin e tij nga porositësi edhe pse nuk ishte likuiduar kësti i dytë. Në DPV/2010 subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi rrugën “I.T”, p. nr. \*\*, Selitë, Tiranë, e cila përkon me vendndodhjen e apartamentit të blerë nga subjekti.

### **Në lidhje me pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie**

31. Në kontratën e porosisë datë 25.3.2010, palët kanë përcaktuar se çmimi i apartamentit do të paguhej nga porositësi me këste, ku: (i) kësti i parë me vlerë 25.000 euro është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës; dhe (ii) kësti i dytë me vlerë 36.000 euro do të likuideohej brenda datës 25.3.2012.

32. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se pagesat për apartamentin janë kryer nga bashkëshortja e subjektit pranë shoqërisë “F-M K” sh.p.k., me mandatpagesat si vijon:

- i) shuma 25.000 euro është paguar përmes mandatpagesës nr. \*\*, datë 25.3.2010;

<sup>5</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.8.2020, ASHK Tiranë Jug ka dërguar dokumentacionin tekniko-ligjor të pasurisë: kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, e lëshuar në datën 19.8.2020; kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\*, datë 5.10.2011; mandat bankar datë 20.10.2011 i “Credins Bank”, i nënshkruar nga z. Erion Pano, për pagesën në favor të tatim-taksave të shumës 600 lekë; mandat bankar datë 20.10.2011 i “Credins Bank”, i nënshkruar nga z. Erion Pano për pagesën e tarifës së shërbimit të ZVRPP-së në shumën 2.300 lekë; faturë arkëtimi datë 10.10.2011 dhe mandat bankar datë 10.10.2011 i “Credins Bank”, e nënshkruar nga shoqëria “F-M K” sh.p.k., për pagesën e taksës së shitjes së pasurisë, në llogari të Bashkisë Tiranë, në shumën 83.150 lekë; vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. \*\*\*, datë 19.9.2011, për pasurinë me nr. \*\*\*, apartament me sip. 83 m<sup>2</sup>, në pronësi të “F-M K” sh.p.k. dhe hartë treguese e pasurisë; ekstrakt QKR i shoqërisë “F-M K” sh.p.k.

<sup>6</sup>Kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 5.10.2011.

<sup>7</sup>Dokumentacioni i depozituar nga subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2020: kontratë porosie (për ndërtim dhe dorëzim apartamenti), datë 25.3.2010, e lidhur ndërmjet sipërmarrësit “F-M K” sh.p.k. dhe porositësit E.P; mandatpagesë nr. \*\*, datë 25.3.2010, për pagesën e shumës 25.000 euro (kësti i parë) nga znj. E.P; mandatpagesë nr. \*\*, datë 5.10.2011, për pagesën e shumës 36.000 euro nga E.P; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 5.10.2011, me palë shitëse “F-M K” sh.p.k. dhe blerës z. Erion Pano; vërtetim nga dokumentet hipotekore me nr. \*\*\*, datë 21.10.2011 dhe hartë treguese për pasurinë apartament me nr. \*\*\*, e lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë në datën 21.10.2011.

<sup>8</sup>Kontrata e shitblerjes e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 5.10.2011.

ii) shuma 36.000 euro është paguar përmes mandatpagesës nr. \*\*\*, datë 5.10.2011.

33. Gjithashtu, nga dokumentacioni<sup>9</sup> i administruar prej shoqërisë sipërmarrëse “F-M K” sh.p.k. provohen pagesat për blerjen e apartamentit përmes mandatpagesave.

34. Nga verifikimi i deklaramëve periodike në vitet 2010 dhe 2011 subjekti ka deklaruar vlerën e apartamentit sipas kësteve të paguara në vitet përkatëse, ku në DPV/2010 ka deklaruar “paguar shuma 25.000 euro”, ndërsa në DPV/2011 është deklaruar “paguar shuma 36.000 euro”.

### **Në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit**

35. Komisioni ka verifikuar vlerën e tregut të lirë të apartamenteve, referuar çmimit të EKB-së<sup>10</sup> në vitin 2010, në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë, ku sipas vendndodhjes së apartamentit në zonën \*\*, vlera e tregut të lirë është 88.000 lekë/m<sup>2</sup> dhe për apartamentin me sipërfaqe banimi 83 m<sup>2</sup> + sip. e përbashkët 9.8 m<sup>2</sup>, çmimi i apartamentit do të ishte 8.166.400 lekë (rreth 59.000 euro), ndërsa subjekti e ka blerë 61.000 euro. Gjithashtu, Komisioni ka administruar nga shoqëria ndërtuese “F-M K” sh.p.k. kontrata të ngjashme shitblerjeje të apartamenteve në të njëjtën godinë ku ndodhet apartamenti i blerë nga subjekti, ku nga verifikimi i kontratave të shitblerjes<sup>11</sup> për apartamentet e shitura nga kjo shoqëri tek palët e treta çmimi i shitjes në vitin 2011 varion nga 78.000 lekë/m<sup>2</sup> - 88.000 lekë/m<sup>2</sup> dhe, përfundimisht, nga hetimi nuk u evidentua ndonjë trajtim preferencial i subjektit për çmimin e blerjes së apartamentit.

36. Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt interesi të mundshëm të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë sipërmarrëse “F-M K” sh.p.k. dhe administratorin e saj, z. A. L.

37. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>12</sup> ka informuar se shtetasi A.L ka pasur çështje penale të regjistruara pranë kësaj prokurorie dhe nga verifikimi i dokumentacionit<sup>13</sup> ka rezultuar se këto çështje nuk janë hetuar nga prokurori Erion Pano.

### **Komisioni analizoi burimet e krijimit të pasurisë**

38. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se si burim për këstin e parë me shumë 25.000 euro, të paguar në datën 25.3.2010, janë përdorur: (i) hua në shumën 10.000 euro, marrë shtetasit A.V; dhe (ii) shuma 15.000 euro nga paratë e tërhequra në datën 19.6.2008, të investuara në bono thesari në emrin e z. Erion Pano në shumën 1.900.000 lekë (e konvertuar në muajin gusht të vitit 2008 me kursin e kohës 122

<sup>9</sup>Dokumentacion i regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2021: kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 5.10.2011, notere A.S; vërtetim nga dokumentet hipotekore me nr. \*\*\*, datë 21.10.2011; harta treguese e pasurisë nr. \*\*\*, planimetri e apartamentit nr. \*\*, mandatpagesa nr. \*\*, datë 5.10.2011; mandatpagesa nr. \*\*, datë 25.3.2010; kontratë porosie, datë 25.3.2010, e lidhur pranë shoqërisë ndërtuese “F-M K” sh.p.k.

<sup>10</sup>Udhëzimi nr. 3, datë 3.2.2010 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2010”.

<sup>11</sup>Dokumentacion i përcjellë nga shoqëria “F-M K” sh.p.k., regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2022: (1) kontratë shitblerjeje (apartament banimi me sip. 88.1 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkët 10.8 m<sup>2</sup>) nr. \*\*\*, datë 6.10.2011, në vlerën 7.760.000 lekë; (2) kontratë shitblerjeje (apartament sipërfaqe banimi 103 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përbashkët 9.8 m<sup>2</sup>) nr. \*\*\*, datë 5.12.2011, në vlerën 9.064.000 lekë. (3) kontratë shitblerjeje (apartament) me nr. \*\*\*, datë 2.6.2014, për apartament me sip. 83 m<sup>2</sup> + sipërfaqe e përbashkët 9.8 m<sup>2</sup>, në vlerën 7.843.500 lekë. (4) kontratë shitblerjeje (apartament sipërfaqe banimi 83 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përbashkët 9.8 m<sup>2</sup>) nr. \*\*\*, datë 4.11.2011, në vlerën 8.166.400 lekë; (5) kontratë shitblerjeje (apartament banimi me sip. 86.6 m<sup>2</sup>) nr. \*\*\*, datë 28.9.2011, në vlerën 38.900 euro; (6) kontratë shitblerjeje (apartament banimi me sip. 79.3 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përbashkët 9.8 m<sup>2</sup>), nr. \*\*\*, datë 2.11.2011, në vlerën 7.840.800 lekë.

<sup>12</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2021 dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2021.

<sup>13</sup>(1) procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2013, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, hetuar nga prokurorja E.K; (2) procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2012, për veprën penale “vrasje me dashje”, me kallëzues A.L, hetuar nga prokurori E. K; (3) kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2006, për veprën penale “kanosje”, hetuar nga prokurori D.N; (4) kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2009, i hetuar nga prokurori Q.D.

lekë), me burim kursimet nga puna të subjektit dhe bashkëshortes, prej vitit 2001 deri në vitin 2007.

39. Ndërsa për këstin e dytë me vlerë 36.000 euro, të paguar në datën 5.10.2011, subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer: (i) huaja në shumën 3.000.000 lekë, marrë nga shtetasi N.M(e konvertuar me kursin e kohës 141.0 lekë, ku vlera e konvertuar ishte rreth 21.000 euro); (ii) shuma 842.063 lekë, bono thesari në emër të bashkëshortes, e tërhequr në datën 24.2.2011 (e konvertuar në muajin gusht me kursin e këmbimit rreth 140 lekë, ku vlera e konvertuar është 6.000 euro) me burim kursimet e subjektit dhe bashkëshortes nga puna për periudhën 2001 – 2010; (iii) diferenca prej 9.000 euro ka si burim një pjesë të kursimeve *cash* të akumuluar nga puna e subjektit dhe bashkëshortes për periudhën 2001 – 2011, ku sasia e parave e kthyer me kursin e kohës ishte 1.250.000 lekë.

40. Komisioni hetoi dhe analizoi të gjitha burimet e deklaruara për blerjen e apartamentit, si vijon:

**i. Hua në shumën 10.000 euro, marrë shtetasit A.V në datën 12.12.2008**

41. Komisioni, për shkak të marrëdhënies së huas, e ka konsideruar z. A.V si “person tjetër të lidhur” në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar informacion pranë institucioneve vijuese:

42. QKB-ja<sup>14</sup> ka konfirmuar se në emër të z. A.V rezultojnë veprimtaritë tregtare si më poshtë:

- a) Shoqëria “U.S” sh.p.k. (\*\*\*), me NUIS K\*\*\*\*I, ku shtetasi A.V është ortak me 100% të kuotave të shoqërisë dhe ka qenë administrator deri më 23.7.2013. Sipas ekstraktit historik, kjo shoqëri figuron e regjistruar në datën 17.11.2007 dhe aktualisht është me status “pezulluar”, që prej datës 9.10.2014.
- b) Shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. me NUIS J\*\*\*\*B, ku shtetasi A.V figuron ortak me 100% të kuotave, si dhe ka qenë administrator deri më 23.7.2013 (larguar). Sipas ekstraktit historik, kjo shoqëri figuron e themeluar në datën 25.5.1994 dhe regjistruar në datën 16.9.2007 me status “aktiv”.
- c) Shoqëria “\*\*\* E” sh.p.k. me NIPT K\*\*\*\*S, ku shtetasi A.V ka qenë administrator dhe ortak me 100% të kuotave në këtë shoqëri deri më 2.7.2013 (larguar). Sipas ekstraktit historik, kjo shoqëri është regjistruar në datën 1.1.2003 dhe themeluar në datën 10.9.1999, me status “aktiv”.

43. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë<sup>15</sup> ka informuar se nga verifikimi i të dhënave në sistemin C@TS, kontabilitet dhe arkiv, ka rezultuar se shtetasi A.V është i regjistruar pranë kësaj drejtorie për aktivitetet e biznesit:

- a) Shoqëria “\*\* S” sh.p.k. (\*\*\*), me NUIS K\*\*\*\*I, ku shtetasi A.V është aksioner me 100% të aksioneve të shoqërisë, e kaluar me status “pasiv” në datën 26.12.2014 janë dërguar të ardhurat e deklaruara për periudhën 2007 – 2014 dhe nuk ka detyrime të papaguara pranë organit tatimor deri në datën 1.9.2020.
- b) Shoqëria “\*\*\* E” sh.p.k., me NIPT K\*\*\*\*S, ku shtetasi A.V ka qenë administrator dhe aksioner me 100% të aksioneve dhe janë dërguar të ardhurat e deklaruara për periudhën 2003 – 2019. DRT-ja ka informuar se deri në datën 1.9.2020 shoqëria ka detyrime të

<sup>14</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2020.

<sup>15</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020.



papaguara pranë organit tatimor në shumën 22.216 lekë, detyrime të shtyra në datën 31.12.2021.

44. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj pranë DPT-së<sup>16</sup> ka informuar se shtetasi A.V rezulton aksioner me 100% të aksioneve në shoqërinë \*\*\* me NIPT J\*\*\*B, me datë regjistrimi 25.8.1998. Sipas të dhënave në sistemin C@TS, z. A.F.V rezulton i punësuar në shoqëri deri në korrik të vitit 2013.

#### **Analiza e fakteve të rezultuara nga hetimi**

45. Lidhur me shumën e huas 10.000 euro, të marrë nga shtetasi A.V, subjekti ka depozituar kontratën e huamarrjes nr. \*\*\*, datë 12.12.2008, përmes së cilës huadhënësi A.V në datën e nënshkrimit të kontratës i ka dhënë subjektit Erion Pano një hua në shumën 10.000 euro, jashtë zyrës noteriale, me afat kthimi për 2 vjet (10.11.2008 – 10.11.2010). Në kontratë evidentohen disa gabime materiale.

46. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se shuma e huas i është shlyer huadhënësit ndër vite dhe e plotë në datën 12.12.2014, e dokumentuar me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 12.12.2014, ku huadhënësi A.V dhe huamarrësi Erion Pano kanë deklaruar, ndër të tjera, se me marrëveshje kanë shtyrë afatin e kthimit të huas për rreth 2 vjet (afati i mëparshëm deri në datën 10.11.2010), pa i ngarkuar huamarrësit ndonjë detyrim shtesë dhe deklarojnë se huamarrësi ka shlyer plotësisht shumën e huas prej 10.000 euro.

47. Nga aktet në dosje evidentohen transaksione të konsiderueshme bankare në emër të z. A.V, midis të cilave edhe tërheqja e shumës 20.000 euro prej tij pranë “ProCredit Bank”, me datë transaksioni 2.12.2008 (disa ditë para nënshkrimit të kontratës së huadhënies më 12.12.2008).

48. Komisioni ka hetuar lidhur me ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me huadhënësin dhe shoqëritë e tij<sup>17</sup> dhe, nga përgjigjet e ardhura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>18</sup>, rezultoi se shtetasi A.V ka pasur çështje penale të regjistruara pranë kësaj prokurorie, dhe, nga verifikimi i kryer<sup>19</sup>, ka rezultuar se këto çështje nuk janë hetuar nga prokurori Erion Pano.

➤ Nga hetimi i Komisionit nuk evidentohet ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe huadhënësit.

#### **Burimi i ligjshëm i huas me shumë 10.000 euro**

49. Komisioni i ka kërkuar<sup>20</sup> subjektit të provojë me dokumentacion burimet e ligjshme të huadhënësit, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, për shumën e huas, si dhe të shpjegojë marrëdhënien që ka me këtë shtetas.

50. Subjekti ka shpjeguar<sup>21</sup>, ndër të tjera, marrëdhënien familjare me huadhënësin: *“Konkretisht, bashkëshorti i kushërirës në shkallë të dytë, A.V (P), është vajza e K.P (kushëriri i parë, djali i dajës së babait tim). Në periudhën e marrjes së huas shtetasi A.F.*

<sup>16</sup>Shkresë nr. \*\*\*, datë 30.7.2020.

<sup>17</sup>Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; shoqëria “\*\*\*\* E” sh.p.k.; shoqëria “\*\* S” sh.p.k.

<sup>18</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2021 dhe shkresë nr.\*\*\* prot., datë 6.12.2021.

<sup>19</sup>1) Kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2014, me prokuror G. T.; (2) procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2014, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, hetuar nga prokurori P. V.; (3) kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2016, i kryer nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., i hetuar nga prokurori Y. B.; (4) kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2019, me prokuror Y. B.; (5) kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2017, për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me prokuror R. K.; (6) kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2021, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, i hetuar nga prokuror P. H.; (7) kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2007, me prokuror A. Xh.

<sup>20</sup>Përmes pyetësorit me *email* datë 14.10.2021.

<sup>21</sup>Në përgjigje të pyetësorit datë 14.10.2021, mbërritur në datën 31.10.2021.

V ka qenë në cilësinë e administratorit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me ortak të vetëm “\*\*\*” sh.p.k.”.

51. Për të provuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, subjekti ka depozituar<sup>22</sup> dokumentacionin vijues:

- vendime të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., të datave 25.6.2008 dhe 30.5.2009, me ortak të vetëm A.V, për miratimin e bilancit ekonomik-financiar të shoqërisë për vitet 2007 dhe 2008;
- pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën kontabël 1.1.2008 - 31.12.2008;
- raporti i ekspertit kontabël të autorizuar dhe pasqyrat financiare të shoqërisë “\*\*\* U” sh.p.k., për periudhën janar – dhjetor 2008;
- *statement* bankar<sup>23</sup> i pjesëzuar i llogarisë së shtetasit A.V pranë “Alpha Bank”, ku evidentohet tërheqja prej tij e shumë 20.000 euro, në datën 27.11.2008;
- kopje e fragmentuar/shkëputur nga dokumenti që provon rezultatin e vitit ushtrimor (fitimi) 2008 për universitetin “\*\*\*”, sipas së cilës fitimi *neto* i realizuar nga kjo shoqëri për vitin fiskal 2008 është në vlerën 169.240.740 lekë;
- vërtetime të lëshuara nga zyra e burimeve njerëzore të A.U, ku konfirmohen të ardhurat vjetore *bruto* dhe *neto* të shtetasit A.V si administrator i universitetit (shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.), si dhe të bashkëshortes A.V, për periudhën 1.1.2008 – 31.12.2008.

52. Komisioni hetoi mbi investimet e kryera nga huadhënësi në pasuri të luajtshme e të paluajtshme, si dhe likuiditetet në bankë deri në vitin 2008, ku nga informacioni i ardhur nga ASHK Tiranë Jug<sup>24</sup> dhe ASHK Tiranë Veri<sup>25</sup> është evidentuar një numër i konsiderueshëm pasurish të paluajtshme<sup>26</sup>, të regjistruara në pronësi të z. A.V deri në vitin

<sup>22</sup>Dokumentacion i dërguar nga subjekti me *email*, datë 1.11.2021, 9.3.2022 dhe *email*, datë 12.4.2022: (1) vendimi nr. \*, datë 25.6.2008, i ortakut të vetëm të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., z. A.V, për miratimin e bilancit ekonomik-financiar të shoqërisë për vitin 2007; (2) vendimi nr. \*, datë 30.5.2009, i ortakut të vetëm të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. për miratimin e bilancit ekonomik-financiar të vitit 2008 dhe perspektivat e shoqërisë për vitin 2009; (3) shkresa datë 26.6.2009 e shoqërisë “\*\*\*” drejtuar QKB-së dhe Degës së Tatim-Taksave; (4) pasqyrat financiare, periudha kontabël 1.1.2008 - 31.12.2008.; (5) raporti i ekspertit kontabël të autorizuar dhe pasqyrat financiare të shoqërisë “\*\*\* U” sh.p.k., për periudhën janar – dhjetor 2008; (6) vërtetim nr. \*\* prot., datë 4.3.2022 dhe vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2022, i lëshuar nga A.U; (7) vërtetim nr. \*\* prot, datë 4.3.2022 dhe vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2022, i lëshuar nga A.U; (8) *statement* bankar i pjesëzuar i llogarisë së shtetasit A.V pranë “Alpha Bank”.

<sup>23</sup>Dokument shtesë i depozituar nga subjekti me *email*, datë 12.4.2022.

<sup>24</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.8.2020.

<sup>25</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2022.

<sup>26</sup>1) Apartament me sip. 212.50 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), blerë nga z. A.V me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 4.12.2007, në vlerën 318.750 euro; (2) apartament me sip. 91.70 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), blerë nga z. A.V me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 4.12.2007, në vlerën 137.550 euro; (3) apartament me sip. 148.2 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), blerë nga z. A.V me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 4.12.2007, në vlerën 222.300 euro; (4) apartament me sip. 88 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), në pronësi të z. A.V sipas certifikatës së pronësisë datë 5.9.2001, e fituar me kontratë këmbimi datë 14.6.1995 (kjo pasuri është shkëmbyer me pasurinë nr. \*\*\*); (5) truall me sip. 120 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*), blerë nga z. A.V me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 12.10.1995. Mbi këtë truall është ndërtuar një objekt 7-katësh nga investitori A.V në bazë të lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 25.10.1998 “Objekt 7 kat në favor të A.V në rrugën H. H”, ku ndodhen pasuritë: apartament nr. \*\*, me sip. 120.3 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*/ND+\*\*); apartament nr. \*\*, me sip. 129 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*/ND+\*\*); apartament nr. \*\*, me sip. 72 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*/ND+\*\*); bodrum, me sip. 90 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*/ND-B); (6) truall me sip. 180 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*), blerë nga A.V me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 21.6.2001, në vlerën 2.000.000 lekë; (7) apartament me sip. 147 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*/ND+\*\*), blerë nga z. A.V me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.2.2007, në vlerën 195.000 euro + pagesa e tatim taksës prej 5.850 euro (e konvertuar në 728.325 lekë); (8) apartament me sip. 147 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*/ND+\*\*), blerë nga z. A.V me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.2.2007, në vlerën 195.000 euro + pagesa e tatim taksës prej 5.850 euro (e konvertuar në 728.325 lekë); (9) apartament me sip. 151 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), blerë nga z. A. V me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 5.12.2007, në vlerën 80.000 euro; (10) truall me sip. 409 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), truall me sip. 70 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*) dhe truall me sip. 75 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*) janë blerë me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 12.12.2007, në vlerën 600.000 euro + tatimi 3% në vlerën 18.000 euro (konvertuar 2.125.800 leke); (11) apartament me sip. 71.50 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), në pronësi të z. A.V, sipas certifikatës së pronësisë (dublikatë) datë 2.10.2006; (12) apartament me sip. 85.50 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), blerë nga z. A.V me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 4.12.2001, në vlerën 1.900.000 lekë; (13) apartament me sip. 49.20 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), e fituar nga z. A.V përmes kontratës së

2008. Gjithashtu, nga kërkimi i kryer në sistemin multifunksional të ASHK-së<sup>27</sup>, në emër të bashkëshortes A.V kanë rezultuar disa pasuri <sup>28</sup> të fituara prej saj për shkak të regjimit martesor ligjor me z. A.V, por këto pasuri rezultojnë të regjistruara në vitin 2014 (pas dhënies së huas subjektit).

53. Ndërsa, nga të dhënat e dërguara nga DPSHTRR-ja<sup>29</sup> mbi automjete në pronësi të huadhënësit dhe bashkëshortes së tij, deri në vitin 2008, janë evidentuar: (1) një automjet<sup>30</sup> i blerë nga z. A.V në datën 4.7.2003, në vlerën 24.300 euro + zhdoganim në shumën 950.167 lekë; si dhe (2) një automjet<sup>31</sup> i përfituar me dhurim<sup>32</sup> në datën 1.3.2002.

### **Analiza financiare mbi mundësitë financiare të huadhënësit për dhënien e huas**

54. Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësitë e huadhënësit A.V për dhënien e huas në shumën 10.000 euro, duke u bazuar në të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes për vitin 2008, nisur nga fakti se huaja është dhënë si individ. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së për vitin 2008 për tre persona (A. V, bashkëshortja dhe djali).

<b>Përshkrimi</b>	<b>2008</b>
Të ardhura A.V, viti 2008	2 130 927
Të ardhura A.V, viti 2008	261 638
<b>Të ardhura total</b>	<b>2 392 565</b>
<b>Shpenzime jetese tre persona</b>	<b>409 860</b>
Huaja me vlerë 10.000 euro	1 231 825
<b>Rezultati financiar</b>	<b>750 880</b>

### **55. Konstatime të Komisionit për huan me vlerë 10.000 euro**

- Nga analiza financiare ka rezultuar se huadhënësi ka pasur mundësi financiare për dhënien e huas.
- Subjekti provoi burimet e ligjshme të huadhënësit A.V për dhënien e huas, në përputhje me pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

shkëmbimit nr. \*\*\*, datë 18.12.2000 (shkëmbyer me pronën \*\*\*); (14) njësi me sip. 69.50 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*N\*\* (korrigjuar nr. pasurie \*\*\*) në pronësi të z. A.V sipas certifikatës së pronësisë datë 4.11.2003; (15) njësi me sip. 49.20 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\* (korrigjuar nr. pasurie \*\*\*) në pronësi të z. A.V sipas certifikatës së pronësisë datë 31.1.2001; (16) njësi me sip. 85.50 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*-N\*\* (korrigjuar nr. pasurie \*\*\*) në pronësi të z. A.V sipas certifikatës së pronësisë datë 15.3.2004; (17) truall me sip. 33.20 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), blerë nga z. A.V në datën 12.12.2007; (18) apartament me sip. 100.50 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*), blerë nga z. V me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.2.2004, në vlerën 130.000 euro + tatimi në shumën 3.900 euro (konvertuar 490.620 lekë).

<sup>27</sup>Sipas vërtetimit të gjeneruar nga sistemi elektronik i ASHK-së në datën 3.10.2022.

<sup>28</sup>(1) pasuria nr. \*\*\*, apartament me sip. 50.70 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Fier, blerë nga z. A.V në vlerën 17.745 euro me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 25.6.2014; (2) pasuria nr. \*\*\*, truall me sip. 33 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 22.50 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Fier, blerë nga z. A.V në vlerën 33.300 euro me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 25.6.2014; (3) pasuria nr. \*\*\*-ND\*, apartament me sip. 141 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Fier, blerë nga z. A.V në vlerën 44.255 euro me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 25.6.2014; (4) pasuria nr.\*\*\*, apartament me sip. 49 m<sup>2</sup> i ndodhur në Fier, blerë nga z. A.V në vlerën 33.300 euro me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 25.6.2014; (5) pasuria nr. \*\*\*, e llojit “truall + ndërtesë” në Përmet; (6) pasuria nr. \*\*/ND+\*\*, e llojit “apartament”, e ndodhur në Tiranë, i ndërtuar në një objekt 7-katësh, nga investitori z. A.V në bazë të lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 25.10.1998 “Objekt 7 kate në favor të A.V në rrugën H. H”;

<sup>29</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2020; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2022 dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2022.

<sup>30</sup>Automjet tip “C. V”, vit prodhimi 2003, me targa TR \*\*\* F.

<sup>31</sup>Automjet tip “M-B”, vit prodhimi 1999, me targa TR \*\*\*H.

<sup>32</sup>Kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 1.3.2002.

## **ii. Bonot e thesarit me shumë 1.900.000 lekë, të tërhequra nga z. Erion Pano në datën 19.6.2008**

56. Lidhur me këtë burim, Komisioni ka hetuar dhe kërkuar informacion pranë Bankës së Shqipërisë<sup>33</sup>, e cila ka informuar se shtetasi Erion Pano ka hapur llogari *cash*/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar, ku nga të dhënat e dërguara evidentohet investimi në bono thesari për periudhën 2003 – 2007, si dhe shuma 1.900.000 lekë bono thesari e emetuar në datën 21.6.2007 dhe maturuar në datën 19.6.2008.

57. Nga të dhënat bankare të subjektit pranë “Raiffeisen Bank”<sup>34</sup> evidentohet kalimi i shumës 1.884.145 lekë, e transferuar në datën 26.6.2008, nga llogaria e bonos së thesarit nga Banka e Shqipërisë, si dhe tërheqja e kësaj shume në vlerën 1.797.500 lekë, në datën 14.8.2008.

### **Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të bonove të thesarit**

58. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se shuma 1.900.000 lekë e bonove të thesarit në emrin e tij është tërhequr e plotë në datën 19.6.2008 dhe ka si burim kursimet e subjektit dhe bashkëshortes nga puna ndër vite. Në vijim, subjekti ka saktësuar<sup>35</sup> se burimi i bonove të thesarit janë kursimet e tij dhe bashkëshortes nga puna për periudhën 2001 – 2007. Sipas shpjegimeve të tij, kjo shumë është mbajtur gjendje *cash* në shtëpi, pasi filluan kërkimet për blerjen e një banese të finalizuar 2 vjet më pas.

59. Subjekti ka depozituar dokumentacion<sup>36</sup> mbi të ardhurat e pagës së tij dhe bashkëshortes ndër vite, të listuar si më poshtë:

- vërtetimet e pagës, të lëshuara nga organi i Prokurorisë, ku subjekti Erion Pano ka ushtruar funksionin e tij si oficer i policisë gjyqësore (për periudhën 2001 – 2005) dhe si prokuror nga viti 2005 dhe në vijim;
- vërtetimet mbi të ardhurat e pagës së bashkëshortes E.P nga punësimi: (i) si juriste pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive në periudhën tetor 2001 - prill 2010; (ii) pedagoge me kohë të pjesshme pranë universitetit “K” në vitin akademik 2011 – 2012; (iii) pedagoge pranë universitetit “\*\*” për periudhën 2006 - 2017; (iv) nga punësimi si lektore pranë Ministrisë së Financës në periudhën mars 2008 – gusht 2013.

60. Nga verifikimi i deklarimeve ndër vite, subjekti ka deklaruar investimet e kryera në bono thesari në deklaratimet periodike për periudhën 2003 – 2008, por nuk ka deklaruar pakësimin e bonove dhe shtesën e likuditeteve *cash* (nga tërheqja e bonove) në deklaratimet vjetore për periudhën 2008 - 2010, të përdorura për blerjen e apartamentit.

<sup>33</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2020.

<sup>34</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2020.

<sup>35</sup>Në përgjigje të pyetësorit standard.

<sup>36</sup>Dokumentacion i depozituar nga subjekti me pyetësorin standard: vërtetim nr.\*\*prot./T. M., datë 12.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të ardhurat nga paga të shtetasit Erion Pano si oficer i policisë gjyqësore në periudhën 16.10.2001 – 15.2.2002; vërtetim datë 17.10.2016 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës për Krimet e Rënda, për të ardhurat e pagës së shtetasit Erion Pano si oficer i policisë gjyqësore, në periudhën janar 2004 - maj 2005; vërtetim datë 4.1.2017 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të ardhurat e pagës së subjektit Erion Pano për periudhën shkurt 2002 - dhjetor 2003 (si oficer i policisë gjyqësore) dhe periudhën qershor 2005 – 2016 (në detyrën e prokurorit); përmbledhëse borderroje për pagat e subjektit Erion Pano, të lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë për vitet 2017, 2018 dhe 2019; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2012, i universitetit “K” për punësimin e znj. E.P si pedagoge me kohë të pjesshme për vitin akademik 2011 - 2012; kopje e pasqyrës së llogarisë bankare të znj. E.P pranë “Union Bank” për periudhën 1.1.2012 – 9.1.2017; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016, i Agjencisë së Trajtimit të Kredive, për punësimin e znj. E.P si specialiste juriste në periudhën tetor 2001 – prill 2010; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2016, i Drejtorisë së Financës nga Ministria e Financës, për të ardhurat e znj. E.P në periudhën mars 2008 – gusht 2013; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2017, i A.U për të ardhurat vjetore të pagës në periudhën e viteve 2006 – 2017.

61. Për nevoja të hetimit, Komisioni ka administruar procesverbalet e shpjegimeve të dhëna nga subjekti në ILDKPKI<sup>37</sup>, ku në procesverbalin e datës 8.3.2016 subjekti ka shpjeguar se arsyeja e mosdeklarimit të pakësimit të bonove të thesarit ka ardhur si pasojë e mospasjes së informacionit të duhur për plotësimin e deklaratave, pasi duke deklaruar depozitën dhe shtesat ndër vite ka menduar se ka përmbushur rregullisht detyrimin ligjor. Sa i takon pakësimit të bonos, subjekti ka shpjeguar se: *“Qëllimi ka qenë pasi në atë periudhë ishte në tratativa për blerjen e një apartamenti, i cili në fakt u realizua në vitin 2010 dhe, pikërisht, një pjesë e madhe e kësaj shume, afërsisht 1.700.000 lekë është përdorur për pagesën e kështit të parë prej 25.000 euro për blerjen e apartamentit”*.

### **Analiza financiare mbi mundësitë për krijimin e bonove të thesarit me shumë 1.900.000 lekë**

62. Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësitë e subjektit dhe bashkëshortes për kursim të shumës 1.900.000 lekë, në periudhën 2001 – 2007, referuar fakteve se subjekti ka deklaruar si burim kursimet e tij dhe të bashkëshortes nga puna ndër vite, për këtë periudhë dhe nga të dhënat e gjendjes civile<sup>38</sup> subjekti ka lidhur martesë me shtetasen E. P, në datën 28.10.2004.

63. Analiza financiare u krye duke përllogaritur të ardhurat në kuptim të ligjit dhe shpenzimet e subjektit për periudhën 2001 – 2007 dhe të bashkëshortes duke filluar nga viti 2004.

64. Komisioni ka analizuar mundësitë financiare të subjektit për krijimin e bonove të thesarit me shumë 1.900.000 lekë, duke marrë parasysh kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore, ku nga analiza e kryer ka rezultuar një balancë negative në shumën totale 590.986 lekë, për vitet 2005 dhe 2006.

### **iii. Hua në shumën 3.000.000 lekë, marrë shtetasit N.M në datën 27.9.2011**

65. Komisioni, për shkak të marrëdhënies së huas, ka konsideruar z. N.M si person tjetër të lidhur, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

66. Lidhur me këtë burim, nga aktet e administruara në dosje ka rezultuar se midis subjektit Erion Pano dhe shtetasit N.M është nënshkruar kontrata e huamarrjes nr. \*\*\*, datë 27.9.2011, përmes së cilës huadhënësi N.M i ka dhënë subjektit huan në shumën 3.000.000 lekë, jashtë zyrës noteriale, me afat shlyerjeje deri më 27.9.2018. Huaja është dhënë pa interes dhe pa u vendosur ndonjë garanci reale mbi pasuri të subjektit për të garantuar kthimin e huas. Në kontratë palët kanë dakordësuar se shuma e huas do të kthehet nga huamarrësi brenda afatit të përcaktuar, pjesë-pjesë, pa u cenuar në asnjë moment nga pala huadhënëse.

67. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se huaja është marrë (8 ditë) para nënshkrimit të kontratës, e cila duket të ketë shërbyer për blerjen e apartamentit.

68. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se shuma e huas i është shlyer huadhënësit ndër vite dhe e plotë në datën 12.10.2016, e dokumentuar me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 12.10.2016, të shtetasit N.M, i cili ka konfirmuar shlyerjen e plotë të shumës së dhënë hua.

69. Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt interesi të mundshëm, të subjektit të rivlerësimit me huadhënësin N.M. Nga përgjigjet e ardhura nga Prokuroria pranë Gjykatës

<sup>37</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2022.

<sup>38</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2021, e Zyrës së Gjendjes Civile.

së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>39</sup>, ku subjekti ka ushtruar funksionin e prokurorit, nuk ka pasur çështje penale të hetuara për këtë shtetas.

### **Burimi i ligjshëm i huas në shumën 3.000.000 lekë**

70. Komisioni i ka kërkuar<sup>40</sup> subjektit të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm të huadhënësit N.M, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të shpjegojë marrëdhënien që ka me këtë shtetas. Subjekti ka shpjeguar<sup>41</sup> se marrëdhënia me të është raport familjar, pasi ky shtetas është bashkëshorti i tezes së tij, znj. M.M.

71. Sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga z. N.M, subjekti ka shpjeguar<sup>42</sup> se: *“Në periudhën e marrjes së huas shtetasi N.P.M ka qenë i angazhuar në biznesin familjar, regjistruar me numër NIPT K\*\*\*V, veprimtari ‘tregti me pakicë kozmetikë’, në emër të djalit E.N.M. Referuar certifikatës familjare në periudhën e kërkuar, familja e N.M përbëhet nga 4 anëtarë. Konkretisht, kryefamiljari N.M, bashkëshortja M. M, vajza J.M dhe djali E.M, kontribues në ekonominë e përbashkët familjare. Burimi i të ardhurave kanë qenë nga pagat e huadhënësit, bashkëshortes, vajzës dhe nga biznesi familjar”.*

72. Subjekti ka depozituar<sup>43</sup> certifikatën familjare të lëshuar në datën 20.1.2020 nga Njësia Bashkiake Tiranë, ku në përbërjen familjare të datës 1.1.2011, shtetasi N.M figuron me bashkëshorten M.M dhe dy fëmijët J dhe E.M.

73. Lidhur me aktivitetin e biznesit familjar në emër të shtetasit E.M (djali i huadhënësit), nga verifikimi në sistemin e QKB-së ka rezultuar se subjekti tregtar “E.M” (person fizik) është regjistruar në datën 2.10.2007, me NUIS K\*\*\*V, me objekt veprimtarie “kozmetikë dhe parfumeri”, me status “aktiv”. Subjekti ka depozituar<sup>44</sup> dokumentacion provues mbi të ardhurat nga ky aktivitet tregtar:

- shkresë e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë e datave 17.1.2020 dhe 12.11.2021, ku konfirmohen të ardhurat e deklaruara dhe qarkullimi i realizuar nga subjekti tregtar E. M me NUIS K\*\*\*V për periudhën 2007 – 2012;
- fatura tatimore shitjeje të viteve 2007, 2009, 2010 dhe 2011 për blerjen e produkteve kozmetike nga subjekti tregtar “E.M” (person fizik);
- pasqyra financiare e vitit 2010 për subjektin tregtar “E.M”, si dhe bilanci mbi të ardhurat dhe shpenzimet e vitit 2009 (1 faqe).

74. Komisioni ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë<sup>45</sup>, e cila ka konfirmuar se shtetasi E.M rezulton i regjistruar në sistemin tatimor si person fizik me NIPT K\*\*\*V, më 2.10.2007, me aktivitet “kozmetikë dhe parfumeri”. DRT-ja ka dërguar të ardhurat e deklaruara nga ky subjekt dhe të dorëzuara në sistemin tatimor C@TS për periudhën 2007 – 2011.

<sup>39</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>40</sup>Përmes pyetësorit me email datë 14.10.2021.

<sup>41</sup>Shpjegimet e subjektit me email datë 31.10.2021.

<sup>42</sup>Në përgjigje të pyetësorit datë 14.10.2021, mbërritur në datën 31.10.2021.

<sup>43</sup>E depozituar nga subjekti me email, datë 1.11.2021.

<sup>44</sup>Dokumentacion i dërguar nga subjekti me email datë 1.11.2021 dhe email datë 23.11.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 14.10.2021: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, mbi të ardhurat e realizuara nga subjekti tregtar E.M në periudhën 2007 – 2012; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2021, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, mbi të ardhurat e deklaruara nga subjekti tregtar E.M në periudhën 2007 – 2012; pasqyra financiare e vitit 2010 për subjektin tregtar E.M me NIPT K\*\*\*V; fatura tatimore shitjeje të vitit 2007, 2009, 2010 dhe 2011 me shitës “\*\*\*” sh.p.k. dhe blerës E.M; bilanc mbi të ardhurat dhe shpenzimet e vitit 2009 (1 faqe).

<sup>45</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2022.

75. Sa u përket të ardhurave familjare të huadhënësit, në dosje është administruar dokumentacioni<sup>46</sup> përkatës i listuar më poshtë:

- shkresat e datave 10.11.2021 dhe 8.11.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të cilat konfirmojnë të ardhurat e shtetasit N.M nga punësimi pranë Drejtorisë së Doganës Vlorë në periudhën qershor 2000 - qershor 2001 dhe pranë Drejtorisë së Doganës Pogradec, në periudhën korrik 2001 – prill 2006;
- vërtetimet<sup>47</sup> e datave 17.1.2020 dhe 4.11.2021, të lëshuara nga A.U, mbi të ardhurat nga punësimi i shtetasës J.M(vajza e huadhënësit) për periudhën 1.2.2006 – 30.11.2012;
- vërtetime për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto*, të lëshuara nga ISSH-ja, ku vërtetohen të ardhurat nga punësimi i znj. M. M (bashkëshortja e huadhënësit) te punëdhënësit: (i) Autoriteti Rrugor Shqiptar për periudhën dhjetor 2002 - shtator 2008; (ii) F. Z. C sh.p.k., për periudhën tetor 2008 - shtator 2009; (iii) “A” sh.p.k. për periudhën 1.1.2010 – 30.11.2010; (iv) studio “R” sh.p.k. për periudhën 7.3.2011 - 31.12.2012;
- vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 27.10.2008 (kopje e panënshkruar), ku është vendosur dëmshpërblimi i shtetasit N.M nga ish-punëdhënësi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në një shumë të barabartë me pagën e 14.5 muajve, si dhe urdhër ekzekutimi nr. \*\*\* Akti, datë 3.3.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lëshuar në favor të shtetasit N.M;
- vendim gjyqësor nr. \*\*\*, datë 22.6.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (vetëm faqet 1, 3, 5 dhe 7) i ndryshuar me vendimin datë 26.10.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku është vendosur dëmshpërblimi i shtetasës M.M (bashkëshortja e huadhënësit) nga ish-punëdhënësi i saj Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, në masën e 18 pagave mujore, si dhe urdhërekzekutimi nr. \*\*\* Akti, datë 2.3.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lëshuar në favor të shtetasës M. M;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2022, i lëshuar nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë dhe nxjerrje llogarie e Zyrës Përmbarrimore Tiranë pranë “Tirana Bank”, për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010, ku evidentohet ekzekutimi i shumës 619.402 lekë, në datën 24.8.2010, në favor të shtetasit N.M;
- vendim nr. \*\*\*/Sh, nr. \*\*\* prot., datë 25.8.2010, “Për pushimin e urdhrit të ekzekutimit” të Zyrës Përmbarrimore Tiranë;

---

<sup>46</sup>Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me *email* datë 1.11.2021 dhe *email* datë 12.11.2021 në përgjigje të pyetësorit datë 14.10.2021: kërkesë për informacion nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për z. N.M për periudhën qershor 2000 - qershor 2001; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, e Degës së Doganës Pogradec, mbi të ardhurat nga paga e z. N.M në periudhën korrik 2001 – prill 2006; vendim nr. \*\*\*, datë 27.10.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse N.M dhe të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (kopje e pa nënshkruar); vendim nr. \*\*\* Akti, datë 3.3.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (faqja 1) për lëshimin e urdhërekzekutimit me kërkues N.M; kërkesë për informacion nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, drejtuar Autoritetit Rrugor Shqiptar lidhur me të ardhurat e znj. M.M; vendim nr. \*\*\*, datë 22.6.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (faqet 1, 3, 5, 7) me paditëse M.M dhe të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve Tiranë; vendimi nr. \*\*\* Akti, datë 2.3.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e urdhërekzekutimit me kërkuese M.M. Dokumentacioni i dërguar nga subjekti me *email* datë 9.3.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 1.3.2022: vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2022, i lëshuar nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë; nxjerrje llogarie e Zyrës Përmbarrimore Tiranë pranë “Tirana Bank”, për periudhën 1 janar 2010 - 31 dhjetor 2010; vendim nr. \*\*\*/Sh, nr. \*\*\* prot., datë 25.8.2010 “Për pushimin e urdhrit të ekzekutimit” të zyrës përmbarrimore Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2012, e Zyrës Përmbarrimore “\*\*\* G” për ekzekutimin e shumës në favor të znj. M.M.

<sup>47</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2021 i A.U (i depozituar nga subjekti në datën 12.11.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 14.10.2021); vërtetim nr. \*\* prot., datë 17.10.2020, i A.U (i depozituar nga subjekti në datën 5.2.2020 në përgjigje të pyetësorit standard).

- shkresë nr. \*\*\*prot., datë 11.4.2012, e Zyra Përmbarimore “\*\*\*G” për ekzekutimin e shumës 979.005 lekë, në favor të shtetases M.M.

76. Komisioni ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat familjare të huadhënësit, përveç shumës së dëmshtëpërblimit prej 979.005 lekësh, të përfituar nga bashkëshortja me vendim gjyqësor, e cila rezulton të jetë përfituar pas dhënies së huas subjektit, për rrjedhojë kjo e ardhur nuk është përfshirë në analizë financiare.

77. Lidhur me investimet e kryera nga huadhënësi deri në momentin e dhënies së huas në vitin 2011, i pyetur<sup>48</sup> nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar<sup>49</sup> se në dijeninë e tij huadhënësi ka blerë një apartament në Tiranë në vitin 2002, por e ka të pamundur objektivisht të kërkojë informacion mbi investime të huadhënësit. Subjekti ka dërguar<sup>50</sup> dokumentacionin mbështetës si vijon:

- kontratë shitblerjeje datë 24.12.2002, përmes së cilës shtetasi N.M dhe bashkëshortja e tij kanë blerë një apartament<sup>51</sup> në Tiranë në vlerën 56.000 USD, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale;
- kontratë kredie datë 28.7.2008<sup>52</sup>, e lidhur midis Bankës Kombëtare të Greqisë sh.a. dhe kredimarrësve E dhe M.M, për marrjen e kredisë në shumën 10.000 euro, me afat 5 vjet, me qëllim blerjen e një apartamenti në Pogradec (porositur me kontratë sipërmarrjeje datë 28.6.2008), ku pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim është në shumën 15.000 euro;
- kontratë shitblerjeje datë 26.12.2017 për blerjen e apartamentit<sup>53</sup> në Pogradec, nga shtetasi N.M, në vlerën 3.000.000 lekë.

78. Komisioni ka hetuar mbi investime në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të huadhënësit dhe familjarëve të tij, deri në momentin e dhënies së huas (viti 2011), ku nga informacioni i ardhur nga DPSHTRR-ja<sup>54</sup> ka rezultuar një automjet i blerë nga shtetasi N dhe E.M, në datën 18.3.2005, në vlerën 200.000 lekë, i zhdoganuar nga z. M, në datën 26.3.2005, në vlerën 340.145 lekë.

79. Në lidhje me investimet në pasuri të paluajtshme të huadhënësit, nga verifikimi në sistemin elektronik të ASHK-së<sup>55</sup>, si dhe aktet e administruara gjatë hetimit, u evidentuan dy pasuri të paluajtshme të blera nga shtetasi N.M deri në vitin 2011, konkretisht: (i) apartament në Tiranë, i blerë në datën 24.12.2002, në vlerën 56.000 USD; dhe (ii) apartament në Pogradec, blerë me kontratë shitblerjeje datë 26.12.2017, në vlerën 3.000.000 lekë dhe prenotuar me kontratë sipërmarrjeje datë 28.6.2008.

80. Në lidhje me pasurinë apartament të blerë në Pogradec nga huadhënësi, Komisioni i ka kërkuar<sup>56</sup> subjektit të depozitojë kontratën e sipërmarrjes datë 28.6.2008 dhe të dokumentojë pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie, për të cilën subjekti ka shpjeguar<sup>57</sup> se nga ana e huadhënësit N.M i është vendosur në dispozicion vetëm kontrata

<sup>48</sup>Përmes pyetësorit me *email* datë 14.10.2021.

<sup>49</sup>Shpjegimet e subjektit me *email* datë 31.10.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 14.10.2021.

<sup>50</sup>*Email* datë 1.11.2021 dhe *email* datë 12.4.2022.

<sup>51</sup>Apartment me sip. 122.28 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*, e blerë nga N.M me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 24.12.2002 (dërguar nga subjekti me *email* datë 1.11.2021).

<sup>52</sup>Kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 28.7.2008, marrë shuma 10.000 euro (dërguar nga subjekti me *email* datë 12.4.2022).

<sup>53</sup>Apartment me sip. 63.5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, blerë nga z. N.M me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 26.12.2017 (dërguar nga subjekti me *email*-in e datës 12.4.2022).

<sup>54</sup>Shkresat nr.\*\*\* prot., datë 21.7.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2022.

<sup>55</sup>Vërtetimet e nënshkruara elektronikisht nga ASHK-ja në datën 3.10.2022, për aplikimin nr. \*\*\*, datë 29.9.2022, aplikimin nr. \*\*\*, datë 29.9.2022 dhe aplikimin nr. \*\*\*, datë 29.9.2022.

<sup>56</sup>Përmes pyetësorit me *email*, datë 3.10.2022.

<sup>57</sup>Shpjegimet e subjektit me *email*, datë 6.10.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 3.10.2022.



e shitblerjes datë 26.12.2017, ndërsa kontratën e sipërmarrjes nuk e disponon, pasi nuk e ka vlerësuar si të nevojshme ruajtjen e saj.

81. Subjekti ka depozituar dokumentacionin që dispononte huadhënësi, lidhur me pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 3.000.000 lekë, i cili konsiston në: (i) transfertën bankare të kryer në datën 31.7.2008, në vlerën 8.237 euro, mbi bazën e kredisë të lëvruar në datën 28.7.2008; (ii) mandatarkëtimin datë 8.5.2009, i kryer pranë NBG, për pagesën e shumës 500.000 lekë; dhe (iii) mandatin bankar datë 13.6.2012, i kryer pranë “Raiffeisen Bank”, për pagesën e shumës 821 euro, me përshkrimin “pagesë kësti apartamenti për llogari të shoqërisë ‘K’ sh.p.k., Pogradec, pagesë për ashensorin”.

82. Sa u përket pagesave të tjera, subjekti ka shpjeguar se z. N.M ka kryer shlyerjen e kësteve ndër vite dhe një diferencë, e pasaktësuar prej tij, është paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës në vitin 2017.

### **Konstatime të Komisionit në lidhje me huan në shumën 3.000.000 lekë**

83. Subjekti ka provuar pagesat e huadhënësit në shumën 1.500.000 lekë deri në qershor të vitit 2012, për blerjen e pasurisë në Pogradec, nga çmimi total i blerjes prej 3.000.000 lekësh, të cilat janë reflektuar në analizën financiare.

84. Lidhur me investimin e huadhënësit për apartamentin në Pogradec, subjekti është ngarkuar për të depozituar dokumentacion mbi pagesën e mbetur për blerjen e kësaj pasurie nga huadhënësi N.M, si dhe paraqitjen e *statement*-it bankar të llogarive të personave familjarë të z. N.M (nëse disponojnë për bashkëshorten dhe fëmijët) pranë “Credins Bank”.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

85. Përmes prapësimeve të depozituara në datën 16.11.2022, subjekti ka shpjeguar se huadhënësi ka kryer të gjitha përpjekjet e mundshme për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar me qëllim gjetjen e kontratës së sipërmarrjes dhe dy mandatet që ai vetë nuk i dispononte, por pavarësisht përpjekjeve nuk ka mundur të kontaktojë me asnjë përfaqësues të shoqërisë, pasi administratori i shoqërisë “K” sh.p.k. ka ndërruar jetë. Subjekti shpjegon se huadhënësi ka mundur të kontaktojë djalin e të ndjerit, shtetasin K.Xh, të cilit i ka kërkuar si verbalisht ashtu edhe nëpërmjet postës elektronike (*email*) informacion për dokumentacionin e kërkuar sa më sipër, por përgjigjja e përcjellë nga djali i administratorit ka qenë negative. Për të provuar këtë fakt subjekti ka depozituar:

- kopje të certifikatës së vdekjes së shtetasit A.Xh (ndërruar jetë në datën 17.8.2022), të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Pogradec, në datën 7.11.2022;
- *email* dërguar shtetasit K.Xh si dhe kthim përgjigje datë 8.11.2022, të nënshkruar nga ky shtetas, i cili konfirmon se nuk i disponon këto dokumente, pasi personi që merrej me veprimtarinë e shoqërisë ka qenë babai i tij;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 10.11.2022, të lëshuar nga shtetasi N.M, i cili konfirmon, ndër të tjera, se për blerjen e apartamentit në Pogradec, deri në vitin 2011 ka shlyer rreth 1.500.000 lekë, ku mandatpagesat përkatëse ia ka vënë në dispozicion z. Erion Pano. Gjatë vitit 2012 ka kryer dy pagesa, ku një pagesë është në shumën 821 euro për të cilën z. Erion Pano i ka dhënë mandatin përkatës dhe pagesa tjetër në vlerën 1.000.000 lekë ka pasur mandat, por aktualisht nuk e disponon pasi nuk e ka ruajtur. Ky shtetas deklaroi se për pagesën prej 1.000.000 lekësh kujton se në atë periudhë bashkëshortja e tij M.M ka përfituar dëmshpërblim në vlerën 979.005 lekë, si rrjedhojë e vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 22.6.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ndryshuar, me vendimin datë 26.10.2010 të Gjykatës së Apelit. Ndërsa diferenca e

mbetur është shlyer në vitin 2017, kur është finalizuar kontrata e shitblerjes, datë 26.12.2017. Mandatpagesën për vitin 2017 nuk e disponon.

86. Lidhur me detyrimin e subjektit për të paraqitur *statement* bankar të llogarive të familjarëve të z. N.M (nëse disponojnë për bashkëshorten dhe fëmijët) pranë “Credins Bank”, me prapësimet e datës 16.11.2011, subjekti ka depozituar vërtetime<sup>58</sup> të lëshuara nga kjo bankë, e cila konfirmon se ky shtetas (N.M) është klient i bankës nga data 23.10.2017, shtetasi E.M është klient i bankës nga data 20.3.2019 dhe J.M është kliente nga data 29.1.2013 e në vijim.

### **Vlerësimi i Komisionit**

87. Komisioni, pasi analizoi aktet e administruara në prapësime, si dhe shpjegimet e subjektit, vlerësoi se shpjegimet e subjektit duhen pranuar me arsyetimin se huadhënësi nuk ka pasur detyrimin për të qenë i kujdesshëm në mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit përkatës dhe kjo rrethanë nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, në kuptim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

88. Lidhur me të dhënat bankare të llogarive të personave familjarë të z. N.M pranë “Credins Bank”, pas analizimit të tyre ka rezultuar se këto llogari janë çelur pas vitit 2011, pra, pas dhënies së huas nga z. N.M, fakt i cili nuk afekton analizën financiare të kryer nga Komisioni.

89. Përfundimisht, Komisioni ka përfshirë në analizë financiare të gjitha të ardhurat familjare të huadhënësit me burime të ligjshme, në përputhje me dispozitat ligjore që parashikon neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe investimet në pasuri të luajshme dhe të paluajshme të dokumentuara nga huadhënësi dhe familjarë të tij, deri në momentin e dhënies së huas, në datën 27.9.2011. Për sa më sipër, analiza financiare e kryer nga Komisioni mbi mundësitë e z. N.M për dhënien e huas mbetet e pandryshuar me ato të rezultuara në raportin e hetimit, sa vijon:

### **Analiza financiare mbi mundësitë e huadhënësit N.M për dhënien e huas**

90. Komisioni kreu një analizë financiare bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje për të vlerësuar mundësitë e huadhënësit për dhënien e huas në shumën 3.000.000 lekë, me burime të ligjshme sipas tabelës më poshtë, për periudhën 2003 – 2011, ku u morën në konsideratë:

- të ardhurat nga paga e shtetasit N.M për periudhën 2003 – 2006, në shumën 1.360.790 lekë;
- të ardhurat nga ekzekutimi i urdhrit datë 24.8.2010, në shumën 619.402 lekë;
- të ardhurat nga paga të vajzës për periudhën 2006 – 2011, në shumën 2.700.081 lekë;
- të ardhurat nga paga e bashkëshortes për periudhën 2003 – 2011, në shumën 3.214.038 lekë;
- të ardhurat nga biznesi i regjistruar në emër të djalit për periudhën 2008 – 2011, në shumën 2.012.054 lekë;

---

<sup>58</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, lëshuar nga “Credins Bank”, ku rezulton se z. N.M është klient nga data 23.10.2017 e në vazhdim; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, lëshuar nga “Credins Bank”, ku rezulton se z. E.M është klient nga data 20.3.2019 e në vazhdim; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2022, lëshuar nga “Credins Bank”, ku rezulton se znj. J.M është kliente nga data 29.1.2013 e në vazhdim; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2022, lëshuar nga “Credins Bank”, ku rezulton se znj. M.M nuk ka qenë asnjëherë kliente e kësaj banke.

- sipas certifikatës mbi përbërjen familjare, z. N.M ka qenë me bashkëshorten dhe dy fëmijët dhe shpenzimet jetike u përlogaritën sipas standardit të ILDKPKI-së për katër persona;
- në analizën financiare u përlogarit edhe vlera e blerjes së një automjeti në vitin 2005, në shumën totale 540.145 lekë;
- në analizë financiare janë përfshirë kreditë bankare në shumën 10.000 euro nga shtetasi E.M (për blerje apartamenti) dhe kredia në shumën 470.000 lekë nga shtetasja J.M (personale);
- referuar dokumentacionit provohet që shtetasi N.M ka blerë një pasuri në dhjetor të vitit 2002, në shumën 56.000 USD. Për efekt të analizës do të përfshihen të ardhurat e familjes M për periudhën 2003 – 2011.

### **Tabela e analizës financiare për periudhën 2003 – 2011**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 2003 – 2011</b>
<b>Apartament i blerë në vitet 2008 – 2009</b>	<b>1 500 000</b>
N.M – paga <i>neto</i>	1 980 192
J.M (e bija) – paga <i>neto</i>	2 700 081
M.M (e shoqja) – paga <i>neto</i>	3 214 038
Të ardhurat nga biznesi në emër të djalit	2 012 054
Kredi E.M në “Alpha Bank”, viti 2008	1 231 825
Kredi J.M “Raiffeisen Bank”	470 000
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>11 608 190</b>
Shpenzime jetese katër persona	4 360 568
Blerje e automjetit në vitin 2005	540 145
<i>Hua dhënë subjektit në vitin 2011</i>	<i>3 000 000</i>
Pagesë këstesh kredie J.M	612 157
Shpenzime kredie 2008 – 2011	1 045 123
<b>Total shpenzime</b>	<b>9 557 993</b>
<b>Rezultati financiar</b>	<b>550 197</b>

91. Nga analiza e kryer për periudhën 2003 – 2011 ka rezultuar se huadhënësi ka pasur burime të ligjshme për dhënien e huas, pasi ka rezultuar me balancë pozitive. Trupi gjykues çmon se u provuan burimet e ligjshme të huadhënësit N.M për dhënien e huas, në përputhje me parashikimin ligjor të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

#### **iv. Bono thesari me shumë 848.947 lekë, në emër të bashkëshortes, e tërhequr në datën 24.2.2011**

92. Lidhur me këtë burim, Komisioni ka hetuar dhe kërkuar informacion pranë Bankës së Shqipërisë<sup>59</sup>, e cila ka informuar se shtetasja E.P rezulton të ketë hapur llogari për blerjen e bonove të thesarit, ku nga të dhënat e dërguara evidentohet shuma e bonos së thesarit 848.948 lekë, e emtuar në datën 18.2.2010 dhe e maturuar në datën 17.2.2011.

<sup>59</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2020.

93. Të dhënat bankare të bashkëshortes së subjektit pranë “ProCredit Bank”<sup>60</sup> evidentojnë kreditimin e shumës 842.063 lekë, të transferuar nga llogaria e bonove të thesarit nga Banka e Shqipërisë.

94. Komisioni ka analizuar burimet e krijimit të bonove të thesarit në emrin e bashkëshortes, ku në deklaraten *Vetting* subjekti ka deklaruar se shuma 848.947 lekë e bonove të thesarit është tërhequr në datën 24.2.2011 dhe ka si burim kursimet e subjektit dhe bashkëshortes nga puna ndër vite.

95. Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar<sup>61</sup> në mënyrë të detajuar se: *“Shuma prej 842.063 lekësh, me sa mbaj mend, kjo sasi parash u konvertua në muajin gusht me kursin e këmbimit rreth 140 lekë. Sasia e konvertuar është në vlerën 6.000 euro. Kjo shumë është burim i kursimeve të mia e të bashkëshortes nga puna jonë prej vitit 2001 deri në vitin 2010. Shuma është tërhequr në datën 24.2.2011 bono thesari (në emër të shtetases E.P) Banka e Shqipërisë”*.

96. Subjekti ka depozituar dokumentacion<sup>62</sup> mbi të ardhurat e pagës së tij dhe bashkëshortes ndër vite.

97. Nga verifikimi i deklarimeve periodike në vite ka rezultuar se investimet e bashkëshortes në bono thesari janë deklaruar nga subjekti në DPV/2006, ndërsa në deklaratimet vjetore vijuese për periudhën 2007 – 2013 nuk ka deklarim të shtesave apo pakësime të gjendjeve të llogarive në bono thesari në emër të bashkëshortes.

98. Referuar shpjegimeve të subjektit, mbajtur në procesverbalin e datave 14.2.2013 dhe 8.3.2016 pranë ILDKPKI-së, mospasqyrimi i këtyre gjendjeve në DPV që nga viti 2008 ka ndodhur për shkak se subjekti nuk ka qenë shumë i informuar mbi kursimet personale të bashkëshortes dhe shumën 848.947 lekë, të cilën e kishte si gjendje bono thesari në datën 31.12.2010 në Bankën e Shqipërisë e ka transferuar në “ProCredit Bank” në vitin 2011. Lidhur me mosdeklarimin e shtesës dhe pakësimit, subjekti ka shpjeguar<sup>63</sup> se kjo ka ardhur si pasojë e mospasjes së informacionit të saktë të plotësimit të deklaratave, duke theksuar se shtesa ka si burim të ardhurat nga paga, të cilat i ka deklaruar.

99. Në procesverbalin e datës 14.2.2013 të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se: *“Për pagesën e këstit të dytë të apartamentit janë përdorur: (a) huaja e marrë nga z. M; dhe (b) pakësimi i kursimeve të tjera nga gjendja cash në shumën 1.600.000 lekë, të cilat janë kursime të akumuluar nga puna ndër vite si prokuror dhe puna e bashkëshortes, të deklaruara periodikisht çdo vit”*.

---

<sup>60</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2020 dhe nr.\*\*\* prot., datë 7.8.2020.

<sup>61</sup>Në përgjigje të pyetësorit standard.

<sup>62</sup>Dokumentacion i depozituar nga subjekti me pyetësorin standard: vërtetim nr. \*\* prot/T. M., datë 12.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të ardhurat nga paga e z. Erion Pano si oficer i policisë gjyqësore, në periudhën 16.10.2001 – 15.2.2002; vërtetim datë 17.10.2016 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës për Krimet e Rënda, për të ardhurat e pagës së z. Erion Pano si oficer i policisë gjyqësore, në periudhën janar 2004 - maj 2005; vërtetim datë 4.1.2017 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të ardhurat e pagës së subjektit Erion Pano për periudhën shkurt 2002 - dhjetor 2003 (si oficer i policisë gjyqësore) dhe periudhën qershor 2005 – 2016 (në detyrën e prokurorit); përmbledhëse borderoje për pagat e subjektit Erion Pano, e lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë për vitet 2017, 2018 dhe 2019; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2012, i universitetit “K” për punësimin e znj. E. P si pedagoge me kohë të pjesshme për vitin akademik 2011 - 2012; kopje e pasqyrës së llogarisë bankare të znj. E. P pranë “Union Bank” për periudhën 1.1.2012 – 9.1.2017; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016 i Agjencisë së Trajtit të Kredive, për punësimin e znj. E.P si specialiste juriste në periudhën tetor 2001 – prill 2010; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2016, i Ministrisë së Financës, për të ardhurat e znj. E.P në periudhën mars 2008 – gusht 2013; vërtetim nr. \*\* prot., datë 18.1.2017, i A.U për të ardhurat vjetore të pagës në periudhën 2006 – 2017.

<sup>63</sup>Shpjegimeve të subjektit pranë ILDKPKI-së, mbajtur në procesverbalin datë 8.3.2016.

100. Gjithashtu, në procesverbalin e datës 14.2.2013, mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se: “... *shuma e tërhequr nga llogaria bankare në shumën 842.063 lekë na ka shërbyer në vitin 2011 për kompletimin e apartamentit të blerë*”.

101. Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore, subjekti nuk ka deklaruar në DPV/2011 pakësimin e bonove të thesarit, të përdorura si burim për blerjen e apartamentit.

#### **Analiza financiare mbi investimet në bono thesari të bashkëshortes**

102. Komisioni ka analizuar mundësitë financiare të bashkëshortes së subjektit për investimin në bono thesari, ku nga analiza e kryer ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 21.588 lekë për investimin në bono thesari për vitin 2009. Subjekti, përmes prapësimeve të depozituara në datën 16.11.2022, ka dhënë shpjegime dhe dokumentacion mbështetës, të cilat janë analizuar nga Komisioni në vijim të këtij vendimi.

#### **v. Interesat e bonove të thesarit, kursimet *cash* në banesë të akumuluar ndër vite me burim nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes**

103. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se për blerjen e apartamentit janë përdorur edhe interesat e bonove të thesarit, si dhe gjendja *cash* në banesë, e akumuluar ndër vite nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes. Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar<sup>64</sup> se për pagesën e këstit të dytë, ndër të tjera, është përdorur edhe shuma 9.000 euro, e cila ka si burim një pjesë të kursimeve *cash* të akumuluar prej vitit 2001 deri në vitin 2011, me burim të ardhurat nga paga.

104. Subjekti ka deklaruar interesat e bonove të thesarit në deklaratimet periodike<sup>65</sup> të viteve 2004, 2007 dhe 2009. Në analizën financiare janë reflektuar shumat përkatëse bazuar në të dhënat bankare të administruara në dosje.

105. Komisioni ka verifikuar kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti në DPV-në për periudhën 2003 – 2011, si dhe shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ<sup>66</sup>, si dhe në procesverbalet<sup>67</sup> e mbajtura pranë ILDKPKI-së, ku ka deklaruar se nuk ka pasur dijeni për plotësimin e deklaratave dhe në procesverbale ka deklaruar, ndër të tjera, se: (a) huaja e marrë nga z. A.V në vlerën 10.000 euro është mbajtur gjendje *cash* deri në vitin 2010; (b) bonot e thesarit në shumën 1.900.000 lekë, të tërhequra në vitin 2008 në shumën 1.797.500 lekë janë mbajtur gjendje *cash* deri në vitin 2010; (c) gjendje e likuiditeteve në vitin 2011, në shumën 1.500.000 lekë<sup>68</sup>; (ç) gjendja e likuiditeteve *cash* në vitin 2014 është 1.100.000 lekë<sup>69</sup>.

106. Nga hetimi i Komisionit evidentohet pasaktësia në lidhje me kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike ndër vite.

#### **Shpenzimet e mobilimit të apartamentit**

107. Lidhur me shpenzimet e mobilimit, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se paratë e shpenzuara për mobilimin e shtëpisë janë shtrirë në kohë që nga lidhja e martesës dhe, në kushtet e një familjeje të re, çdo vit kanë shpenzuar shuma simbolike në raport me të ardhurat e tyre. Subjekti ka shpjeguar se shtëpia e tij me sip. 83 m<sup>2</sup> ka një

<sup>64</sup>Në përgjigje të pyetësorit standard.

<sup>65</sup>Te rubrika e “të ardhurave”.

<sup>66</sup>Shpjegimet e subjektit me *email* datë 9.3.2022 në përgjigje të pyetësorit datë 1.3.2022.

<sup>67</sup>Procesverbalet e ILDKPKI-së të mbajtura në datat 3.7.2009, 8.3.2016 dhe 14.2.2013.

<sup>68</sup>Deklaruar nga subjekti në procesverbalin e datës 14.2.2013, të mbajtur në ILDKPKI.

<sup>69</sup>Deklaruar nga subjekti në procesverbalin e datës 8.3.2016, të mbajtur në ILDKPKI.

mobilitim modest, për të cilin kanë investuar ndër vite, ku, me sa mban mend, në vitin 2004 kanë shpenzuar 150.000 lekë, në vitet 2005 dhe 2006 kanë shpenzuar rreth 180.000 lekë, si dhe kredia prej 400.000 lekësh e marrë pranë “ProCredit Bank” në datën 10.12.2008, e mbyllur në qershor të vitit 2011, ndërsa pas vitit 2011 subjekti deklaroi se ka kryer blerje rast pas rasti për shtëpinë në përmbushje të nevojave të jetesës.

108. Në kontratën e porosisë, datë 25.3.2010, përcaktohet se apartamenti i është dorëzuar z. Erion Pano në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, me qëllim shfrytëzimin e tij, ndërsa më sipër subjekti ka deklaruar kryerje të shpenzimeve për mobilitim në vitet 2004, 2005 dhe 2006 dhe në DPV/2008 ka deklaruar kredinë me vlerë 400.000 lekë në “ProCredit Bank” për rinovim banese (blerje pajisjesh shtëpiake).

Nga përmbajtja e kontratës së kredisë<sup>70</sup>, të lidhur me “ProCredit Bank” në datën 10.12.2008, ka rezultuar se në vitin 2008 subjekti dhe bashkëshortja kanë marrë një kredi në shumën 400.000 lekë për rikonstruksion/rinovim të banesës aktuale të ndodhur në adresën: blloku “V.Sh”, pallat i ri, Tiranë.

109. Nisur nga faktet e mësipërme, Komisioni i ka kërkuar<sup>71</sup> subjektin të shpjegojë dhe saktësojë se për cilën banesë janë kryer këto shpenzime mobilimi, i cili ka shpjeguar<sup>72</sup> se: *“Paratë e shpenzuara për mobilimin e shtëpisë janë të shtrira në kohë që nga martesa me E.P. Shpenzimet e kryera në vitet 2004, 2005 dhe 2006, si dhe kredia e vitit 2008 kanë qenë kryesisht në funksion të blerjeve të pajisjeve elektroshtëpiake, orendi, si dhe mobilie (tavolinë, karrige, divan etj.). Që prej momentit kur janë kryer këto shpenzime prej nesh, është planifikuar që elektroshtëpiaket, si dhe orenditë e tjera të lëvizshme, si televizor, tavolinë, karrige, divan, tapet, enë kuzhine etj., do të ishin një investim për të ardhmen. Në këtë kuptim, shpenzimet e kryera në periudhën sa më lart kanë qenë në funksion të pasurisë së apartamentit 83 m<sup>2</sup>, në të cilin banoj me familjen time prej vitit 2010”.*

110. Komisioni i ka kërkuar subjektin të shpjegojë arsyet e marrjes së kësaj kredie, pasi referuar deklaratimeve të subjektit në vitin 2008 ka pasur kursime *cash* në shtëpi në vlera të konsiderueshme (shuma 1.797.500 lekë tërhequr nga bonot e thesarit dhe 10.000 euro marrë hua nga A. V).

111. Subjekti ka shpjeguar<sup>73</sup> se në vitin 2008 ka tërhequr nga bonot e thesarit kursimet e krijuara ndër vite, të cilat i ka mbajtur *cash* në banesë dhe kanë pasur si të vetmin destinacion investimin në blerjen e një apartamenti banimi, e cila është finalizuar 2 vjet më vonë.

112. Sipas shpjegimeve të subjektit, në periudhën në fjalë (viti 2008) ka shfaqur interes për të blerë apartamentin ku banonte, në pronësi të shtetasit A.R, por kjo gjë nuk ndodhi pasi kushtet e pagesës dhe çmimi i ofruar nuk ishin të përballueshme. Në vijim, subjekti ka saktësuar se: *“Si një familje e re, me një fëmijë të mitur, ne vazhdimisht kemi pasur nevojë për të plotësuar kërkesa të ndryshme për blerje orendi shtëpiake apo çdolloj gjëje që ishte në funksion të jetesës. Arsyetja e marrjes së kredisë në vitin 2008 ka pasur si qëllim plotësimin e nevojave tona familjare”.*

<sup>70</sup>Kontratë kredie dhe hipotekimi datë 10.12.2008 e lidhur midis “ProCredit Bank” dhe kredimarrësve E.P dhe Erion Pano.

<sup>71</sup>Përmes pyetësorit me *email* datë 1.3.2022.

<sup>72</sup>Shpjegimet e subjektit me *email* datë 9.3.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 1.3.2022.

<sup>73</sup>Shpjegimet e subjektit me *email* datë 6.10.2022.

113. Sipas shpjegimeve të subjektit, në procesverbalin e mbajtur në datën 8.3.2016 pranë ILDKPKI-së<sup>74</sup> lidhur me shpenzimet e mobilimit, subjekti ka deklaruar se për banesën kanë kryer shpenzime të përballuara nga të ardhurat familjare.

#### **Analiza financiare mbi mundësitë financiare për blerjen e apartamentit**

114. Komisioni kreu një analizë financiare në lidhje me burimet e ligjshme për blerjen e apartamentit, referuar deklaramëve të subjektit në DPV sa i përket kursimeve *cash* dhe shpenzimeve të mobilimit.

115. Nga analiza financiare për pasurinë apartament ka rezultuar një balancë negative në shumën totale 4.425.444 lekë. Komisioni, në këtë analizë nuk ka konsideruar shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë procesit, lidhur me kursimet *cash* të deklaruara në vite.

#### **Konstatime të Komisionit për pasurinë apartament**

116. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar:

- Mospërputhje deklarimesh në lidhje me kursimet *cash* të deklaruara në deklaramet periodike ndër vite me shpjegimet e subjektit gjatë hetimit, si dhe shpjegimet sipas procesverbaleve të mbajtura pranë ILDKPKI-së, të cilat duke u analizuar sipas deklaramëve periodike vjetore kanë krijuar një balancë negative në shumën 3.834.458 lekë, për vitet 2009 – 2011.
- Subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e bonove të thesarit dhe shtesën e likuiditeteve *cash* (nga tërheqja e bonove) në deklaramet periodike ndër vite, të përdorura për blerjen e apartamentit.
- Nga analiza financiare, mbi mundësitë për blerjen e bonove të thesarit, subjekti ka rezultuar me një balancë negative në shumën totale 590.986 lekë, për vitet 2005 dhe 2006.

117. Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

118. Në prapësime të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se është i vetëdijshëm mbi pasaktësitë në deklarimin e gjendjeve *cash* deri në vitin 2011, por këto pasaktësi i ka korrigjuar/saktësuar gjatë këtij procesi administrativ, të cilat kanë ardhur si pasojë e perceptimit të gabuar në mënyrën e plotësimit të deklaratave ndër vite, mungesa e eksperiencës, trajnimeve të duhura, si dhe mungesa e vëmendjes dhe dhënies së rëndësisë së duhur në plotësimin e tyre. Subjekti ka shpjeguar se është përpjekur të deklarojë sa më saktë kursimet në total të tij dhe bashkëshortes, pa i diferencuar në kursime *cash* apo në sistemin bankar dhe në asnjë rast nuk ka pasur për qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo deklarimin e rremë, lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit.

119. Sa i përket konstatimit të Komisionit mbi mospërputhjet e deklaramëve të kursimeve *cash* në vite, subjekti ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur gjendjen e tij financiare për periudhën 2005 – 2016 ku, ndër të tjera, ka argumentuar se shuma 10.000 euro, e marrë hua nga shtetasi A.V, është deklaruar në vitin 2008 në seksionin “detyrimet financiare” dhe duke qenë se kjo shumë nuk ishte kursim vjetor, nuk e ka deklaruar më vete si gjendje *cash*, por si detyrim.

<sup>74</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2022.

120. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se në DPV/2008 ka deklaruar kursimet e tij dhe bashkëshortes në shumat 450.000 lekë dhe 350.000 lekë, pra në këtë vit në total kursimet kanë qenë në vlerën 800.000 lekë dhe nuk ka pasur shtesa në sistemin bankar. Sipas subjektit, shumës prej 800.000 lekësh i është shtuar edhe gjendja *cash* e vitit 2007 prej 120.000 lekësh (e përbërë nga shumat 492.019 lekë<sup>75</sup> + 328.186 lekë<sup>76</sup> – 700.000 lekë bono thesari të deklaruara në DPV/2007), si dhe 1.797.500 lekë, tërhequr nga bonot e thesarit dhe 10.000 euro, deklaruar në seksionin “detyrimeve financiare”, të marra hua nga z. A. V. Ndërsa për vitin 2009 subjekti ka deklaruar vlerën 400.000 lekë kursime nga paga e tij me 50% dhe 400.000 lekë kursime nga paga e bashkëshortes me 50 %, ku në fund të vitit 2009 ka pasur gjithsej gjendje *cash* 1.320.000 lekë, e cila është shumatore e viteve 2007, 2008 dhe 2009.

121. Subjekti ka prapësuar se deri në momentin e pagesës së këstit të apartamentit në shumën 25.000 euro, ka pasur nga kursimet *cash* të viteve 2007, 2008 dhe 2009, në shumën totale 1.320.000 lekë, shumën 10.000 euro, të marrë hua dhe lekët e tërhequra *cash* nga bonot e thesarit 1.797.500 lekë. Pas pagesës së këstit të apartamentit në shumën 25.000 euro, shuma e mbetur *cash* në fund të vitit 2010 ka qenë afërsisht 1.355.000 lekë.

122. Më tej, subjekti ka shpjeguar se kursimet e mbetura në fund të vitit 2010, si dhe kursimet e vitit 2011 janë përdorur për pagesën e këstit të dytë të apartamentit prej 36.000 euro dhe gjendja *cash* në fund të vitit 2011 ka qenë 50.000 lekë, gjendje e cila ka vazhduar deri në fund të vitit 2014 (duke u mbartur nga kursimet e vitit 2011). Subjekti pretendon se mbartja e kursimeve gjatë vitit 2011, sipas analizës financiare të Komisionit, nuk ekziston sepse në vitin 2011 nuk ka pasur mundësi të realizojë kursime të tilla, pasi është finalizuar blerja e apartamentit.

123. Në vitin 2015, subjekti ka deklaruar kursimet nga paga dhe qiramarrje në shumën 500.000 lekë, të mbajtur *cash* në banesë, e cila, së bashku me shumën e mbartur nga viti 2011 prej 50.000 lekësh shkon në vlerën 550.000 lekë.

124. Subjekti ka kundërshtuar analizën e Komisionit, duke shpjeguar se gjendja e likuiditeteve nuk është sipas mënyrës së paraqitur nga Komisioni, por sipas asaj çfarë subjekti ka deklaruar çdo vit në deklaratimet periodike vjetore përkatëse dhe në shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ. Më tej, subjekti ka argumentuar se analiza financiare e Komisionit për vitin 2010 paraqitet me diferencë negative në shumën 3.320.320 lekë, ndërsa në vitin 2008 rezulton me një diferencë pozitive në shumën 3.619.764 lekë, ku është e qartë se shuma e deklaruar si e përdorur për pagesën e këstit të parë, ka qenë gjendje *cash* në shtëpi e mbartur nga vitet 2008 dhe 2009.

125. Subjekti pretendon se në analizën financiare të Komisionit për vitin 2008 nuk është përfshirë shuma e shpërblimit prej 85.000 lekësh, e kredituar në llogarinë e tij pranë “Raiffeisen Bank” dhe kërkon që kjo e ardhur të përfshihet në analizën financiare të vitit 2008. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues: (i) vërtetimin datë 14.11.2022 të lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë, i cili konfirmon kreditimin e shumës 85.000 lekë në llogarinë pranë “Raiffeisen Bank”; si dhe (ii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2008, për dhënie shpërblimi, të lëshuar nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme.

126. Sa i përket bonove të thesarit të përdorura si burim për blerjen e apartamentit, në prapësimet e tij, subjekti ka shpjeguar se shuma 1.797.500 lekë është produkt i kursimeve

<sup>75</sup>Kursime të subjektit të deklaruara në DPV/2007.

<sup>76</sup>Kursime të bashkëshortes të deklaruara në DPV/2007.



familjare ndër vite dhe mosparaqitja e kësaj vlere si gjendje *cash* ka ardhur si pasojë e faktit se kjo shumë është lehtësisht e verifikueshme nga sistemi bankar dhe nuk e ka perceptuar si të nevojshme për ta deklaruar.

127. Sipas perceptimit të tij, tërheqja e shumave (përkatesisht 1.797.500 lekë, tërhequr në datën 14.8.2008 dhe 842.063 lekë, tërhequr në datën 24.2.2011) të depozituara në bonot e thesarit nuk përbënin ndryshim të mirëfilltë pasurie (një e ardhur shtesë), pasi ka qenë vetëm një lëvizje e pasurisë ekzistuese të deklaruar më parë prej tij, nga gjendja faktike në sistemin bankar për në banesë, duke u ndryshuar vendi i ruajtjes së shumave respektive. Subjekti ka shpjeguar se gjatë periudhës gusht 2008 – mars 2010 nuk janë krijuar pasuri të tjera të paluajtshme apo të luajtshme të asnjë lloji apo të jenë kryer shpenzime që do të justifikonin ndryshimin e destinacionit të përdorimit të shumës së disponuar nga bonot.

128. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, për sa i përket mospërputhjeve të deklarimeve të kursimeve *cash* në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka shpjeguar se nga leximi me vëmendje i këtyre procesverbaleve, konkretisht atij të datës 14.2.2013, vëren dy gabime materiale të bëra nga personi që ka mbajtur procesverbalin, lidhur me shumën e paraqitur si pagesë për apartamentin, e cila gjendet e shkruar 31.000 euro, ndërkohë që ajo e saktë është 36.000 euro. Po kështu, një tjetër gabim material është në paraqitjen e shumës 1.500.000 lekë si të mbetur *cash* në banesë, për të cilën subjekti ka argumentuar se kjo shumë nuk mund të ekzistonte në fund të vitit 2011, pasi në këtë vit ka finalizuar blerjen e apartamentit, ku si burim për pagesën e kështit prej 36.000 euro, ka pasur të gjitha kursimet e mbetura në fund të viteve 2010 dhe 2011, si dhe huan në vlerën 3.000.000 lekë. Sipas subjektit, këto tre zëra financiarë janë deklaruar specifikisht prej tij në procesverbalin e datës 14.2.2013. Në këto rrethana, subjekti pretendon se nuk ka asnjë logjikë që ndërkohë që dispononte vlerën 1.500.000 lekë, të merrte një hua në vlerën 3.000.000 lekë për të plotësuar vlerën totale të paguar.

129. Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka pasur mundësi për blerjen e bonove të thesarit duke rezultuar me balancë negative për vitet 2005 dhe 2006, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se në vitin 2005 nuk ka pasur gjendje *cash* në shtëpi, pasi në këtë vit nuk kanë pasur mundësi të krijojnë kursime, siç ka rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni.

130. Subjekti ka shpjeguar se gjendja totale e likuiditeteve në fund të vitit 2005 ka qenë 1.130.303 lekë, e përbërë nga shuma 800.000 lekë bono thesari (300.000 lekë bono thesari, e deklaruar në vitin 2005, shtuar gjendja e mëparshme prej 500.000 lekësh e vitit 2003), shuma 165.357 lekë në llogarinë e subjektit pranë “Raiffeisen Bank”<sup>77</sup> dhe shuma 164.946 lekë në llogarinë e bashkëshortes E.P në “ProCredit Bank”<sup>78</sup>. Për rrjedhojë, subjekti pretendon se në vitin 2005 nuk rezulton me balancë negative në shumën 88.823 lekë, por me tepriçë në shumën 311.117 lekë.

131. Sa i përket balancës negative për vitin 2006, subjekti ka prapësuar se në DPV/2006 ka deklaruar kursime në para nga paga me vlerë 700.000 lekë, kursime nga paga të depozituara në bono thesari 400.000 lekë, kursime nga paga (bashkëshortja), depozituar në bono thesari në shumën 300.000 lekë. Sipas subjektit, kursimet e këtij viti prej 700.000 lekësh janë depozituar në sistemin bankar dhe gjendja e kursimeve *cash* ka qenë 0 (zero) lekë. Sipas subjektit, shtesa e likuiditeteve në vitin 2006 nuk ka qenë në vlerën 1.176.134

<sup>77</sup>Gjendja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” për vitin 2005.

<sup>78</sup>Gjendja e llogarisë në “ProCredit Bank” për vitin 2005.

lekë, siç i ka rezultuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni, por ka qenë në vlerën 876.134 lekë.

132. Subjekti pretendon se në analizën financiare për vitin 2006 nuk janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortes nga paga vjetore si pedagogje e jashtme pranë A.U, në shumën 63.000 lekë, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2017 (përcjellë edhe më parë prej tij), si dhe shuma e shpërblimit prej 22.500 lekësh nga paga e bashkëshortes si juriste pranë ATK-së. Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016, të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, ku evidentohen të ardhurat, si dhe shpërblimi prej 22.500 lekësh, përfituar nga bashkëshortja.

133. Në vijim, në prapësimet e tij, subjekti pretendon se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2006 nuk janë në shumën 264.021 lekë, siç janë reflektuar në analizën financiare të Komisionit, pasi në pyetësonin standard subjekti ka shpjeguar se shpenzimet<sup>79</sup> për 4 udhëtime të realizuara në Strugë dhe në Maqedoninë e Veriut, në total janë afërsisht 500 euro. Subjekti ka shpjeguar se udhëtimin e ka realizuar me familjarët, prindërit, motrën, bashkëshorten dhe djalin dhe akomodimi është bërë në një apartament të kompletuar me të gjitha pajisjet elektroshtëpiake, prandaj shpenzimet e tjera (konsumimi i vakteve) kanë qenë minimale. Ndërsa shpenzimet e qirasë së apartamentit ku kanë qëndruar bashkërisht janë mbuluar nga babai i tij. Subjekti deklaroi se e ka të pamundur të vërtetojë sot me një dokument qëndrimin e tyre në këtë apartament, për shkak të kohës së kaluar dhe informalitetit.

134. Subjekti pretendon se viti 2006 nuk del me balancë negative në shumën 502.163 lekë, por me tepriçë në shumën 85.135 lekë.

135. Ndërsa për vitin 2007, subjekti ka shpjeguar se në DPV-në e këtij viti ka deklaruar kursime nga paga e tij në shumën 492.019 lekë dhe kursime të bashkëshortes në shumën 328.186 lekë. Pra, kursimet në total të familjes së tij për vitin 2007 kanë qenë në shumën 820.205 lekë, nga të cilat 700.000 lekë u investuan në blerje bono thesari dhe gjendja *cash* në këtë vit ka qenë afërsisht 120.000 lekë (492.019 lekë + 328.186 lekë – 700.000 lekë bono).

136. Përfundimisht, subjekti ka prapësuar se mënyra e plotësimit të deklaratave periodike vjetore prej tij ka ardhur si pasojë e një konteksti të caktuar, siç është edhe perceptimi i gabuar në mënyrën e plotësimit të deklaratave periodike ndër vite. Subjekti ka referuar disa qëndrime tashmë të konsoliduara, të mbajtura nga Komisioni<sup>80</sup> dhe Kolegji<sup>81</sup>, ku evidentohet se pasaktësitë në deklarime, për sa kohë që nuk shoqërohen me mungesa të burimeve të ligjshme për të krijuar pasurinë *cash* apo pasuri të tjera të deklaruara vit pas viti, nuk mund të përbëjnë shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

### **Vlerësimi i Komisionit lidhur me likuiditetet *cash* të deklaruara**

137. Trupi gjykues, në mbështetje të deklarimeve të subjektit, prapësimeve të tij, si dhe dokumentacionit të administruar në dosje dhe dokumentacionit të depozituar në prapësime, vlerëson se fillimisht është i nevojshëm analizimi i çështjes nëse pasaktësia lidhur me

<sup>79</sup>Shpenzimet për udhëtimin në datat 30.12.2006 – 2.1.2007 kanë qenë rreth 198 euro; shpenzimet për udhëtimin në datat 2.4.2006 – 3.4.2006 kanë qenë rreth 35 euro; shpenzimet për udhëtimin në datat 20.7.2006 – 22.7.2006 kanë qenë rreth 70 euro; shpenzimet për udhëtimin në datat 23.7.2006 – 6.8.2006 kanë qenë rreth 200 euro.

<sup>80</sup>Vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 152/2019, datë 7.6.2019 dhe nr. 311/2020, datë 21.10.2020.

<sup>81</sup>Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020, nr. 14/2021 (JR), datë 15.6.2021, nr. 24/2021 (JR), datë 28.7.2021, nr. 1/2022 (JR), datë 27.1.2022, nr. 27/2022 (JR), datë 6.7.2022, nr. 29/2022 (JR), datë 21.7.2022.

likuiditetet *cash*, për shkak të mosdeklarimit si gjendje *cash* në deklaratimet periodike, mund të prodhojë pasojat e një deklarimi të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe, për pasojë, të afektojë me paligjshmëri burimet e krijimit të kësaj pasurie.

138. Nga një analizë logjike e të gjitha fakteve të rezultuara gjatë hetimit, si dhe deklaratimeve të subjektit ndër vite dhe në deklaratën *Vetting*, trupi gjykues konstaton se lidhur me pasurinë e deklaruar dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë konstante në çdo deklaratim periodik investimet e kryera në bono thesari, si dhe shumat e huave deri në shlyerjen e plotë të tyre, të përdorura si burim për blerjen e apartamentit.

139. Trupi gjykues ka marrë në konsideratë në mënyrë integrale dhe në harmoni me njëra-tjetrën, faktet dhe rrethanat e rezultuara nga hetimi, si vijojnë:

- i. Nga aktet e administruara rezulton i provuar investimi i kryer nga subjekti në bono thesari me shumë 1.900.000 lekë nga viti 2003 deri në vitin 2007, si dhe tërheqja e kësaj shume në vlerën 1.797.500 lekë në datën 14.8.2008. Gjithashtu, nga aktet provohet me dokumentacion se subjekti ka marrë shumën e huas prej 10.000 euro nga shtetasi A.V, përmes kontratës së huamarrjes datë 12.12.2008.
- ii. Subjekti ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore investimet në bono thesari në shumën 1.900.000 lekë pranë Bankës së Shqipërisë për periudhën 2003 – 2007, shumën e huas prej 10.000 euro, si dhe shlyerjet e kryera çdo vit në deklaratimet periodike për periudhën 2008 – 2014, deklarime këto që rezultojnë të jenë të njëjta me atë të deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* nga subjekti, duke bërë të besueshëm këtë deklaratim të fundit, referuar vlerës provuese që kanë deklaratat periodike vjetore të pasurisë, në përputhje me parashikimin e pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me investimet në bonot e thesarit dhe marrjen e huas nga huadhënësi është deklarim i saktë, në përputhje me detyrimin ligjor sipas nenit 4, germa “dh” e ligjit nr. 9049/2003.
- iii. Sa i përket shpjegimeve të subjektit se mosdeklarimi i pakësimit të bonove të thesarit dhe shtesa e likuiditeteve *cash* (nga tërheqja e bonove dhe huaja e marrë nga shtetasi A.V) në deklaratimet periodike në vite ka ardhur, pikërisht, si pasojë e perceptimit të gabuar të tij, pasi duke deklaruar huan dhe investimet në bono thesari kishte përmbushur detyrimin për deklarim, Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit duken bindëse, në kushtet kur këto likuiditete burojnë nga kursimet familjare ndër vite të dokumentuara, si dhe nga një marrëdhënie e ligjshme huamarrjeje, në kuptim të nenit 1050 e vijues të Kodit Civil.
- iv. Nga verifikimi i kujdesshëm i akteve të hetimit administrativ nuk rezultoi asnjë e dhënë sipas së cilës, gjatë periudhës 2008 – 2010, një periudhë relativisht e shkurtër e ruajtjes *cash* të shumës së tërhequr nga bonot e thesarit prej 1.797.500 lekësh dhe huaja me shumë 10.000 euro, subjekti i rivlerësimit të ketë krijuar pasuri të tjera të asnjë lloji si pasuri të paluajtshme apo pasuri të luajtshme (automjete, depozita bankare etj.) apo të ketë kryer shpenzime që do të justifikonin ndryshimin e destinacionit të përdorimit të shumave të disponuara në gjendje *cash*.
- v. Nga informacioni i ardhur nga ASHK Tiranë rezultoi se pasuria apartament me sip. 83 m<sup>2</sup>, në Tiranë, vazhdon ende të jetë e vetmja pasuri e paluajtshme e subjektit të rivlerësimit dhe nga hetimi nuk kanë rezultuar pasuri të tjera të blera prej tij.

- vi. Komisioni ka vlerësuar se nuk mund të lihet pa vënë re edhe faktin se nga autoritetet ndihmëse për kriterin e kontrollit të figurës nuk është raportuar asnjë dyshim apo *indicie* për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, të cilat mund të shërbenin për të lëkundur (apo krijuar) bindjen se subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në banesë për 2 vjet të shumës 1.797.500 lekë nga bonot e thesarit dhe huan prej 10.000 euro, nëse do të provohej nga hetimi se do t'i kishte shpenzuar ato, për pasojë pagesa e këstit të parë prej 25.000 euro do të buronte nga burime të paidentifikuara.

140. Në vlerësim të deklaramëve dhe fakteve sa më sipër, Komisioni çmon se pavarësisht se situata faktike nuk është deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, nga hetimi i kryer nuk ka rezultuar që kjo pasaktësi në deklarim të kursimeve *cash* të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri apo të ketë shërbyer si shkak apo burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër nga subjekti, çka krijon bindjen e Komisionit se pasaktësitë e konstatuara janë të paqëllimshme dhe se deklaramet e subjektit në deklaratën *Vetting* ndihmojnë për të kuptuar drejt deklaramet e tij ndër vite dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se këto pasaktësi nuk mund të përbëjnë shkak për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli.

141. Sa i përket mospërputhjeve të konstatuara nga Komisioni mbi deklarimin e kursimeve *cash* në procesverbalet e mbajtura pranë ILDKPKI-së, subjekti ka pranuar faktin se ka pasur një perceptim të gabuar mbi plotësimin e deklaratës. Nisur nga shpjegimet e subjektit, nëse do të kryhet një verifikim i deklaramëve prej vitit 2011 dhe në vijim, duket se z. Erion Pano ka filluar të saktësojë deklaramet e tij dhe mënyrën e deklarimit të kursimeve *cash* (pakësimet apo shtesat, sipas detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003), çka krijon bindjen e Komisionit se shpjegimet e subjektit qëndrojnë dhe gjejnë harmoni me mënyrën e deklarimit në vijim.

142. Trupi gjykues e vlerësoi të drejtë pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë financiare të shumës së shpërblimit prej 85.000 lekësh të kredituar në llogarinë e tij pranë “Raiffeisen Bank”, si dhe të të ardhurave të bashkëshortes nga paga si pedagoge pranë A. U në shumën 63.000 lekë dhe shuma e shpërblimit prej 22.500 lekësh të përfituar nga punëdhënësi Agjencia e Trajtimit të Kredive, duke reflektuar ndryshimet përkatëse në analizën financiare.

143. Sa i përket pretendimit të subjektit se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2006 kanë qenë në vlerë më të vogël, trupi gjykues çmon të mos e marrë në konsideratë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë shpjegim specifik apo provë për të vërtetuar këtë pretendim, i cili mbeti në nivel deklarativ. Për këtë arsye, vlera e shpenzimeve të udhëtimeve e pasqyruar në analizën financiare të Komisionit mbetet e pandryshuar.

144. Në vlerësim të Komisionit, në konsekuencë edhe të qëndrimeve tashmë të konsoliduara, të mbajtura nga Kolegji, pasaktësitë në deklarime nuk mund të shërbejnë si shkelje të tilla që të formojnë bazën e duhur ligjore për shkarkim. Ky qëndrim, i mbështetur në analizim të parashikimeve të pikës 3 të nenit 61, që të drejtojnë te neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë edhe me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si një parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi, përpjekjet e subjektit për defektimin e deklaramëve të tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, parakusht që përjashton pasaktësitë në deklarime, si një premisë për shkarkim, përveç rastit kur ato janë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin

e pasaktë të të dhënave, përfshirë edhe ato lidhur me burimet e krijimit të pasurisë, të cilat natyrshëm nuk mund të kualifikohen si pasaktësi, por si deklaratime të rreme dhe fshehje e pasurisë.

145. Nga një analizë logjike e të gjitha fakteve të rezultuara gjatë hetimit, trupi gjykues çmon se deklaratimet e subjektit përgjatë procesit të rivlerësimit të tij gjejnë harmoni me situatën e pasqyruar në deklaratën *Vetting*. Për rrjedhojë, Komisioni rishikoi analizën financiare, duke marrë në konsideratë kursimet *cash* të saktësuara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe pas prapësimeve analiza financiare mbi mundësitë e subjektit për blerjen e apartamentit për periudhën 2001 – 2011, referuar tabelës së përgjithshme, do të rezultonte me një balancë negative në shumën totale prej 117.163 lekësh, vetëm për vitin 2006.

**146. Në përfundim, Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen dhe duke marrë në konsideratë arsyetimet sa më sipër, çmon se pamjaftueshmëria financiare e rezultuar nga analiza e kryer nga Komisioni është në një masë të tillë që nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, në bazë të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.**

**147. Dy garazhe<sup>82</sup> me sipërfaqe 18.20 m<sup>2</sup> dhe 18.30 m<sup>2</sup>, në S, Tiranë, blerë në datën 11.1.2016 në vlerën 325.000 lekë secili garazh (në total 650.000 lekë)**

148. Si burim krijimi për blerjen e dy garazheve subjekti ka deklaruar se është përdorur shuma 529.339 lekë (e ndodhur në numrin e llogarisë në “Raiffeisen Bank” në emër të shtetases E.P), me burim kursime nga paga e bashkëshortes si eksperte ligjore pranë shoqërisë “\*\* P” sh.p.k. për periudhën 1.6.2015 – 31.12.2015, si dhe vlera prej 120.700 lekësh, pakësuar nga gjendje *cash* në banesë (kursime nga pagat vjetore).

149. Komisioni ka kërkuar informacion pranë ASHK Tiranë Jug<sup>83</sup>, e cila ka dërguar dokumentacionin e pronësisë së dy pasurive garazh të regjistruara në pronësi të z. Erion Pano, konkretisht: (a) garazh me sip. 18.30 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*-G\*\*, vol. \*\*, f. \*\*, z. k. \*\*; dhe (b) garazh me sip. 18.20 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*-G\*\*, vol. \*\*, f. \*\*, z. k. \*\*\*.

150. Nga verifikimi i dokumentacionit<sup>84</sup> tekniko-ligjor provohet blerja e garazheve përmes kontratës së shitblerjes datë 11.1.2016, kundrejt çmimit 325.000 lekë secili garazh, në total 650.000 lekë.

### **Analiza e fakteve**

151. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti Erion Pano ka blerë pranë shoqërisë “F-M K

---

<sup>82</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme (2 garazhe), datë 11.1.2016, për blerje garazhi nr. \*\*, me sip. 18.30 m<sup>2</sup> dhe garazh nr. \*\*, me sip. 18.20 m<sup>2</sup>, të ndodhura në rr. “I.T”, Tiranë. Vlera e secilit garazh është 325.000 lekë, në total 650.000 lekë; (2) certifikatë për vërtetim pronësie nr. pasurie \*\*\*\*+ G\*\*, z. k.\*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*, garazh me sip. 18.20 m<sup>2</sup>, në emër të shoqërisë “F-M” sh.p.k., lëshuar në datën 28.12.2015, shoqëruar me kartelën e pasurisë; (3) certifikatë për vërtetim pronësie nr. pasurie \*\*\*\*+ G\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*, garazh me sip. 18.30 m<sup>2</sup>, në emër të shoqërisë “F-M” sh.p.k., lëshuar në datën 28.12.2015, shoqëruar me kartelën e pasurisë.

<sup>83</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.8.2020.

<sup>84</sup>Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*-G\*\*, garazh me sip. 18.30 m<sup>2</sup>, e lëshuar në datat 19.8.2020 dhe 3.2.2016; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*-G\*\*, garazh me sip. 18.20 m<sup>2</sup>, e lëshuar në datat 19.8.2020 dhe 3.2.2016; inventar i brendshëm i dosjes për pasurinë nr. \*\*\*-G\*\*; aplikim nr. \*\*\*, datë 28.1.2016, për regjistrimin e pasurisë nr. \*\*\*-G\*\* pranë ASHK-së; kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme (2 garazhe) nr. \*\*\*, datë 11.1.2016, me shitës shoqërinë “F-M K” sh.p.k. dhe blerës z. Erion Pano, shoqëruar me certifikatë pronësie me nr. serie \*\*\*; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*-G\*\*, lëshuar në datën 28.12.2015; certifikatë pronësie me nr. serie \*\*\* dhe kartela e pasurisë së paluajtshme nr.\*\*\*-G\*\*, të lëshuara në datën 28.12.2015; ekstrakt i regjistrimit tregtar të shoqërisë “F-M K” sh.p.k., lëshuar nga QKB-ja në datën 12.1.2016; kopje letërnjoftimi i z. Erion Pano dhe z. F.L.

” sh.p.k. dy garazhe me sip. 18.30 m<sup>2</sup> dhe 18.20 m<sup>2</sup>, në vlerën totale 650.000 lekë. Për këtë qëllim, ndërmjet palëve është lidhur kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 11.1.2016, ku përcaktohet se çmimi i blerjes do të kalojë e plotë në llogarinë bankare të shoqërisë “F-M K” sh.p.k.

152. Subjekti ka depozituar<sup>85</sup> kontratën e shitblerjes dhe aktet e pronësisë së dy garazheve, si dhe një nxjerrje llogarie të bashkëshortes E.P nga “Raiffeisen Bank”, ku evidentohet pagesa e çmimit të blerjes në llogarinë e shoqërisë “F-M K” sh.p.k.

153. Nga të dhënat bankare të bashkëshortes pranë “Raiffeisen Bank”<sup>86</sup> evidentohet kalimi i shumës 650.500 lekë në datën 26.1.2016 nga llogaria e znj. E.P në llogarinë e shoqërisë ndërtuese “F-M K” sh.p.k. (rreth 15 ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes datë 11.1.2016).

154. Gjithashtu, nga dokumentacioni<sup>87</sup> i administruar nga shoqëria “F-M K” sh.p.k. evidentohet mbërritja e transfertës prej 650.000 lekësh në llogarinë e kësaj shoqërie përmes mandatit bankar datë 27.1.2016, të “Credins Bank”.

155. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se pagesa për blerjen e dy garazheve është kryer nga bashkëshortja e subjektit përmes llogarisë bankare në datën 26.1.2016.

156. Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë sipërmarrëse, ortakun dhe administratorin e saj, ku nga përgjigjet e ardhura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>88</sup> nuk rezultoi ndonjë nga rastet e konfliktit të interesit të parashikuara në ligj.

157. Komisioni hetoi lidhur me ndonjë trajtim të mundshëm preferencial në blerjen e garazheve, duke administruar nga shoqëria ndërtuese “F-M K” sh.p.k. kontrata<sup>89</sup> të ngjashme shitblerje të garazheve të ndodhura në të njëjtën godinë ku ndodhen garazhet e blera nga subjekti i rivlerësimit dhe nga verifikimi i kryer nuk ngrihen dyshime për çmimin e tyre, pasi ka rezultuar se janë blerë më shtrenjtë krahasuar me çmimet e blerjes së një viti më parë dhe nuk duket se ka çmim preferencial.

Nga hetimi i Komisionit nuk u evidentuan problematika për çmimin e blerjes së garazheve.

### **Komisioni ka analizuar burimin e krijimit për blerjen e garazheve**

158. Lidhur me shumën 529.339 lekë në llogarinë e pagës së bashkëshortes, gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar<sup>90</sup> se kjo shumë është kursyer nga bashkëshortja e tij nga të ardhurat

<sup>85</sup>Dokumentacioni i depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard, regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2020; kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme (2 garazhe) nr. \*\*\*, datë 11.1.2016; certifikatë pronësie dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*-G\*\*, lëshuar në datën 28.12.2015, certifikatë pronësie dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*-G\*\*, të lëshuara në datën 28.12.2015; nxjerrje llogarie e lëshuar nga Raiffeisen Bank në datën 9.1.2017, për E.P në periudhën 9.1.2016 – 9.1.2017.

<sup>86</sup>Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 24.7.2020.

<sup>87</sup>Dokumentacion i regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2021; kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme - 2 garazhe) nr. \*\*\*, datë 11.1.2016, noter A.V; planimetri e garazhit me sip. 18.3 m<sup>2</sup> dhe sip. 18.2 m<sup>2</sup>; mandat bankar datë 27.1.2016, i “Credins Bank”, mbi mbërritjen e transfertës prej 650.000 lekësh në datën 27.1.2016 në llogarinë e shoqërisë ndërtuese.

<sup>88</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2021, nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2021, dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>89</sup>Dokumentacion i përcjellë nga shoqëria “F-M K” sh.p.k., regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2022: kontratë shitblerjeje (garazh 31 m<sup>2</sup>) nr. \*\*\*, datë 14.10.2015, në vlerën 500.000 lekë; kontratë shitblerjeje (garazh 15.4 m<sup>2</sup>) nr. \*\*\*, datë 15.2.2012, në vlerën 3.000 euro; kontratë shitjeje (garazh 15 m<sup>2</sup>) nr. \*\*\*, datë 9.2.2020, në vlerën 3.000 euro.

<sup>90</sup>Në përgjigje të pyetësorit standard.

e pagës si eksperte ligjore pranë shoqërisë “\*\* P” sh.p.k. duke depozituar si dokumentacion provues një vërtetim<sup>91</sup> të kësaj shoqërie, ku të ardhurat *neto* të realizuara për këtë periudhë janë në shumën 530.204 lekë.

159. Në DPV/2015 subjekti ka deklaruar kursimet nga paga e bashkëshortes si eksperte ligjore, në shumën 533.491 lekë.

160. Komisioni ka kërkuar informacion pranë shoqërisë punëdhënëse “\*\* P” sh.p.k., e cila, me vërtetimin<sup>92</sup> datë 10.2.2022 ka konfirmuar marrëdhënien e punësimit të znj. E.P për periudhën 1.6.2015 – 31.12.2018 si dhe ka dërguar të dhëna mbi të ardhurat/pagën mujore *neto* të E.P gjatë periudhës së punësimit.

161. Nga verifikimi i llogarisë bankare të bashkëshortes pranë “Raiffeisen Bank”<sup>93</sup> evidentohet kreditimi i pagës mujore, ku gjendja e llogarisë në datën 31.12.2015 rezulton me balancë 529.339 lekë.

162. Nga verifikimi i llogarisë bankare kjo shumë duhet të jetë përdorur për blerjen e garazheve.

163. Lidhur me shumën 120.700 lekë, pakësuar gjendje *cash* në banesë, në deklaratën *Vetting* dhe DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar se për blerjen e garazheve është përdorur edhe shuma 120.700 lekë, e pakësuar nga gjendja *cash* në banesë (me burim kursimet nga pagat vjetore dhe qiraja e deklaruesit akumuluar ndër vite). Sipas shpjegimeve<sup>94</sup> të subjektit, kjo shumë është pakësuar nga gjendja *cash* në banesë<sup>95</sup>, duke u shtuar në llogarinë e pagës së bashkëshortes në datën 25.1.2016.

164. Subjekti ka depozituar pasqyrën e llogarisë së bashkëshortes pranë “Raiffeisen Bank” për periudhën janar 2016 – janar 2017, ku evidentohet kreditimi në llogari i shumës 120.700 lekë në datën 25.1.2016 (një ditë para kryerjes së pagesës për blerjen e garazheve).

165. Subjekti ka deklaruar në DPV<sup>96</sup> kursimet *cash* dhe pakësimin e kësaj gjendjeje për blerjen e garazheve.

### **Analiza financiare mbi mundësitë e subjektit për blerjen e garazheve**

166. Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësinë e subjektit për blerjen e garazheve për vitin 2015, vit në të cilin janë krijuar gjendja *cash* dhe likuiditetet në bankë. Nga analiza financiare e kryer ka rezultuar një balancë pozitive.

167. Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri ka rezultuar se:

- Subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri, e cila përputhet me aktet e administruara.
- Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi për blerjen e garazheve.

### **168. Truall<sup>97</sup> me sipërfaqe 257 m<sup>2</sup>, në rrugën “H.K”, Tiranë, trashëguar nga babai me trashëgimi ligjore në vitin 2008, me pjesë takuese 1/3 e pasurisë**

<sup>91</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2017, i shoqërisë “\*\*\* P” sh.p.k.

<sup>92</sup>Vërtetim datë 10.2.2022, i shoqërisë “\*\*\* P” sh.p.k., i regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2022.

<sup>93</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2020.

<sup>94</sup>Përgjigjet e pyetësorit standard.

<sup>95</sup>Në DPV/2015 subjekti ka deklaruar: “*Kursime nga paga dhe qiramarrje gjatë vitit 2015 në vlerën 500.000 lekë, shumë të cilën e ka mbajtur gjendje cash në banesë deri në datën 31.12.2015*”.

<sup>96</sup>Në DPV-të e viteve 2015 dhe 2016.

<sup>97</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vendimin nr. \*\*\*, datë 7.3.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “lëshim dëshmie trashëgimie”; certifikatën për vërtetim pronësie, për pasurinë e llojit “truall” me sip. 257 m<sup>2</sup>, me

169. Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është trashëguar nga babai sipas vendimit nr. \*\*\* dhe nr. akti \*\*\*, datë 7.3.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “lëshim i dëshmisë së trashëgimisë”.

170. ASHK Tiranë Veri<sup>98</sup> ka dërguar dokumentacionin e pronës truall me sip. 257 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*, ku subjekti Erion Pano figuron bashkëpronar me 1/3 pjesë të pasurisë.

171. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor<sup>99</sup> (ASIG) ka informuar se nga fotografimi ajror i datës 7.7.2007 mbi pasurinë nr. \*\* nuk rezultojnë gjurmë ndërtimi, ndërsa nga fotografimi ajror i datës 29.5.2015 dhe fotografimi ajror i datës 27.5.2018 rezultojnë gjurmë objekti. Bashkëlidhur shkresës ndodhen pamjet imazherike (*ortofoto*) të printuara nga Gjeoportali Kombëtar për territorin ku ndodhet pasuria nr. \*\*, për vitet 1994, 1999, 2001, 2007, 2015 dhe 2018.

### **Faktet e rezultuara nga hetimi i kryer**

172. Nga verifikimi i dokumentacionit<sup>100</sup> tekniko-ligjor të pasurisë, subjekti rezulton pronar i 1/3 pjesë takuese të pasurisë truall me sip. 257 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*, të ndodhur në rrugën “H.K”, Tiranë. Kjo pasuri është përfituar përmes dëshmisë së trashëgimisë ligjore të çelur me vendim nr. \*\*\*, datë 7.3.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti Erion Pano, së bashku me nënën M.P dhe motrën D.P, janë caktuar trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të z. K.P (babai i subjektit), duke trashëguar nga 1/3 pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të pasurisë trashëgimore.

173. Në deklarimin periodik vjetor të vitit 2008 subjekti ka deklaruar këtë pasuri të përfituar nga çelja e trashëgimisë.

174. Komisioni hetoi lidhur me origjinën e fitimit të pasurisë nga babai K.P, ku nga verifikimi i dokumentacionit të pronës së gjeneruar nga sistemi i ASHK-së evidentohet se kjo pasuri është përfituar nga z. K.P në vitin 1999, përmes trashëgimisë ligjore dhe blerje të pjesëve përkatëse nga trashëgimtarët e tjerë, konkretisht: (a) 1/6-ta pjesë e pasurisë është fituar me trashëgimi ligjore përmes vendimit<sup>101</sup> datë 31.3.1999, të Gjykatës së Rrethit

---

nr. \*\*\*, e ndodhur në z. k. \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*, në emër të shtetasve M.P, D.P dhe E.P, me 1/3 pjesë secili, lëshuar në datën 6.5.2008; vërtetim nga dokumentet hipotekor nr. \*\*\*, datë 4.6.1999, ku është regjistruar pasuria nr. \*\*, e ndodhur në z. k. \*\*\*, me sip. 257 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “H.K”, nr. \*\*, Tiranë, shtëpi banimi e përbërë nga dy kate, ndërtuar pjesërisht prej tulle dhe pjesërisht prej qerpiçi, bashkë me një dyqan që është tek porta e kësaj shtëpie me pjesë pusi dhe portë më vete. Sipërfaqja e përgjithshme e truallit është 257 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja ndërtimore 80 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasit K.P, lëshuar në datën 28.10.2004.

<sup>98</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2022.

<sup>99</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2022.

<sup>100</sup>Kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* (me kod unik \*\*\*), e lëshuar elektronikisht në datën 7.2.2022; inventari i brendshëm i dosjes; kërkesë nr. \*\*\*, muaji/viti 04-2008, drejtuar z. K.P; vërtetim nga dokumentet hipotekorë nr. \*\*\*, datë 4.6.1999, për pasurinë nr. \*\*\* në pronësi të z. K.P; vendim nr. \*\*\*, datë 7.3.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë”; pasaporta të shtetasve Erion Pano, D.P dhe M.P; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 5.2008, e lëshuar nga shtetasit Erion Pano, M.P dhe D.P; kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. \*\*\*, datë 24.5.1999 për blerjen e 1/6 pjesë takuese të pasurisë nga z. K.P, e shoqëruar me hartë treguese (provizore Tirana 1) për pasurinë nr. \*\*\* dhe planimetri të katit përdhe dhe katit të parë; mandatarkëtim (i brendshëm) datë 1.6.1999, e Bankës së Kursimeve për pagesën e taksës për shitjen e pasurisë; aplikim nr. \*\*\*, datë 4.6.1999 dhe aplikim nr. \*\*\*, datë 19.5.1999 (kërkesë për regjistrim dhe lëshim dëshmie e certifikate), e kryer nga z. K.P; vendim nr.\*\*\*, datë 31.3.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshim dëshmie trashëgimie; kartelë e pasurisë së paluajtshme për pasurinë nr. \*\* me në bashkëpronësi të z. K.P me të tjerë; notë transkriptimi e datës 15.6.1957, në favor të shtetasit M.P (gjyshi i subjektit); vërtetim me nr. transkriptimi \*\*\*, datë 17.6.1957, e lëshuar nga Zyra e Hipotekave; kontratë shitjeje (të një shtëpie) datë 7.6.1957; Vendim nr.\*\*\*, datë 22.10.2004, të ZVRPP-së Tirana 1, për regjistrimin e pasurisë nr. \*\*\*, relacion nr. \*\*\*, datë 22.10.2004 i Komisionit të Regjistrimit të ZVRPP-së Tirana 1; kërkesë për regjistrim pronësie në emër të z. K.P; deklaratë personale datë 7.7.2004, e z. K.P; deklaratë noteriale e pronarëve kufitarë, datë 20.5.2004.

<sup>101</sup>Vendim gjyqësor nr. \*\*\*, datë 31.3.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Gjyqësor Tiranë; dhe (b) 5/6 pjesë e pasurisë është blerë nga z. K.P me kontratë shitblerjeje<sup>102</sup>, datë 24.5.1999.

175. Nga hetimi i kryer nga Komisioni, subjekti ka deklaruar saktë pasurinë truall në deklaratën *Vetting*, nga i cili nuk u evidentuan problematika.

**176. Automjet<sup>103</sup> tip “D.Cr”, vit prodhimi 2002, në emër të bashkëshortes së subjektit, blerë në vitin 2016 në vlerën 180.000 lekë**

177. Komisioni ka kërkuar informacion pranë DPSHTRR-së<sup>104</sup>, e cila ka konfirmuar automjetin në pronësi të znj. E.P dhe nga verifikimi i dokumentacionit<sup>105</sup> përkatës ka rezultuar se ky automjet është blerë në Gjermani në datën 11.11.2016, në vlerën 850 euro + zhdoganimi i mjetit në shumën 49.000 lekë i paguar në datën 24.11.2016.

178. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka saktësuar se vlera e mjetit e paraqitur në rubrikën përkatëse të deklaratës *Vetting* me shumë 180.000 lekë gjeneron vlerën prej 850 euro, çmim shitje në Gjermani (konvertuar në lekë me kursin e kohës), detyrimet doganore dhe shërbimet e tjera.

**Komisioni ka analizuar burimet e krijimit të kësaj pasurie**

179. Në deklaratën *Vetting* dhe DPV/2016, subjekti ka deklaruar se shuma e përdorur për blerjen e automjetit ka ardhur nga pakësimi i gjendjes *cash* në banesë, akumuluar nga paga e subjektit dhe qiratë.

180. Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri ka rezultuar se:

- Deklarimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar nga DPSHTRR-ja.
- Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2015 ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi financiare për të blerë automjetin.

**181. Llogari page<sup>106</sup> në shumën 502.854 lekë në “Alpha Bank”, në emër të bashkëshortes**

182. Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar pagat e bashkëshortes, e kontraktuar si pedagoge e jashtme pranë A.U, Tiranë.

183. Nga të dhënat e dërguara nga “Alpha Bank”<sup>107</sup> konfirmohet llogaria bankare në emër të znj. E.P, ku gjendja e llogarisë në datën 17.1.2017 është në shumën 502.845 lekë, e cila përputhet me deklarinimin e subjektit.

<sup>102</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 24.5.1999.

<sup>103</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë pronësie e mjetit tip “D.C”, me targa AA \*\*\* PI, me nr. shasie WDB\*\*\*J\*\*\*, në emër të znj. E.P; leje qarkullimi mjeti me targa AA \*\*\* PI; urdhër çlirimi mjeti, datë 24.11.2016; faturë zhdoganim mjeti e datës 24.11.2016, me vlerë automjeti 850 euro, shuma e detyrimeve doganore 32.086 lekë, marrës E.P; faturë blerjeje në shumën 850 euro, shoqëruar me dokumentacionin e automjetit.

<sup>104</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2020.

<sup>105</sup>Leje qarkullimi rrugor dhe të dhënat lidhur me të, datë 2.12.2016, në emër të znj. E.P; leje e qarkullimit dhe moduli i taksave e shkarkuar nga sistemi i DPSHTRR-së në datën 2.12.2016; certifikatë e kontrollit fizik të mjetit, datë 2.12.2016, në emër të znj. E.P; urdhër çlirimi lëshuar nga Drejtoria e Doganave; deklaratë zhdoganimi i mjetit tip “D.C”, me nr. shasie WDB\*\*\*J\*\*\*, në datën 24.11.2016; mandatarkëtim datë 24.11.2016, i lëshuar nga Banka Amerikane e Investimeve; librezë e mjetit (pjesa I), datë 24.10.2006, e përkthyer me vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep., datë 30.11.2016; librezë mjeti (pjesa II), datë 24.10.2006; faturë shitjeje e përkthyer, datë 11.11.2016; letërnjoftim i znj. E. P.

<sup>106</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie, datë 17.1.2017, e “Alpha Bank”, me balancë të llogarisë në shumën 502.854,05 lekë (bashkëlidhur pozicioni i klientit në datën 17.1.2017).

<sup>107</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2020.

184. Nga hetimi i Komisionit duket se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga banka.

**185. Llogari page<sup>108</sup> në shumën 1.080.498 lekë në “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. E.P**

186. Si burim krijimi për këtë gjendje në llogari, subjekti ka deklaruar pagat e bashkëshortes si eksperte ligjore në shoqërinë “\*\*\*\* P” sh.p.k.

187. Nga të dhënat bankare të ardhura nga “Raiffeisen Bank”<sup>109</sup> evidentohet se gjendja e llogarisë së znj. E.P në vitin 2017 është në shumën 1.080.498 lekë, e cila përputhet me deklarimin e subjektit.

188. Nga hetimi i kryer duket se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

**189. Kursime *cash* në banesë në shumën 7.000 euro, akumuluar prej vitit 2013 deri ditën e deklarimit**

190. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se shuma 7.000 euro ka si burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes prej vitit 2013, si dhe nga qiratë.

191. Nga verifikimi i deklarimeve periodike evidentohet se subjekti nuk ka deklarime të kursimeve *cash* për vitet 2013 dhe 2014, por ka deklaruar kursime për vitet 2015 dhe 2016.

192. Referuar shpjegimeve në procesverbalin e datës 8.3.2016, mbajtur pranë ILDKPKI-së<sup>110</sup>, subjekti është pyetur mbi gjendjen *cash* në datën 31.12.2014, për të cilën ka sqaruar se një pjesë e saj e deklaruar në vitet 2005 - 2011 është përdorur për shlyerjen e dy kësteve për blerjen e apartamentit. Gjendja *cash* në datën 31.12.2014 është afërsisht 1.100.000 lekë.

193. Komisioni ka verifikuar gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti sipas DPV-ve për periudhën 2013 – 2017, sipas shpjegimeve të subjektit në pyetësorë<sup>111</sup>, si dhe në procesverbalet<sup>112</sup> e mbajtura pranë ILDKPKI-së.

194. Nga hetimi i kryer, referuar shumave *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike vjetore, si dhe shpjegimeve në procesverbalin e datës 8.3.2016, të mbajtur në ILDKPKI, ka rezultuar një gjendje *cash* rreth 2.000.000 lekë dhe jo 7.000 euro, siç është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

195. Lidhur me këtë mospërputhje të gjendjes *cash*, Komisioni i ka kërkuar<sup>113</sup> subjektit shpjegime, i cili, në përgjigje të pyetësorit datë 1.3.2022, ka shpjeguar<sup>114</sup> se: (i) gjendja *cash* në vitet 2013 dhe 2014 ka qenë në shumën 50.000 lekë (e cila është mbartur nga kursime *cash* të vitit 2011); (ii) në fund të vitit 2015 gjendja *cash* në banesë ka qenë 500.000 lekë dhe 50.000 lekë (mbartur nga kursimet *cash* të vitit 2011); (iii) për gjendjen *cash* në vitin 2016, subjekti ka shpjeguar se në fund të vitit 2016 ka pasur 927.300 lekë (e

<sup>108</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratë nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 17.1.2017. Balanca e disponueshme e llogarisë është në shumën -1.080.498,65 lekë.

<sup>109</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2020.

<sup>110</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2022.

<sup>111</sup>Shpjegimet e subjektit me *email*-in e datës 9.3.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 1.3.2022.

<sup>112</sup>Procesverbalet e ILDKPKI-së të mbajtura në datat 3.7.2009, 8.3.2016 dhe 14.2.2013.

<sup>113</sup>Përmes pyetësorit me *email*-in e datës 1.3.2022.

<sup>114</sup>Shpjegimet e *email*-it datë 9.3.2022.

cila rrjedh nga 500.000 lekë<sup>115</sup> – 120.700 lekë<sup>116</sup> – 180.000 lekë<sup>117</sup> – 22.000 lekë<sup>118</sup> + 700.000 lekë<sup>119</sup> + 50.000 lekë<sup>120</sup>). Kjo shumë në ditët e para të janarit është konvertuar në euro dhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka pasur gjendje *cash* në banes1 shumën 7.000 euro.

196. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar mospërputhje në deklaratimet e kursimeve *cash* nga subjekti.

### **Burimi i krijimit të kursimeve *cash***

197. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e gjendjes *cash* me shumë 7.000 euro: (a) të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes prej vitit 2013; dhe (b) të ardhurat nga qiradhënia.

198. Në dosje është administruar dokumentacioni përkatës mbi të ardhurat nga punësimi i subjektit si prokuror nga viti 2005 dhe në vijim, si dhe të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi si pedagoge pranë Universitetit \*\*\* (për periudhën 2006 – 2017), nga puna pranë Ministrisë së Financës (në periudhën mars 2008 – gusht 2013), si dhe punësimi pranë shoqërisë “\*\*\* P” sh.p.k. nga qershori i vitit 2015 dhe në vijim.

199. Lidhur me të ardhurat nga qiradhënia, subjekti ka depozituar aktmarrëveshjet e qirasë<sup>121</sup> për dhënien me qira të truallit të ndodhur në rrugën “H.K”, Tiranë, me qira 80.000 lekë/muaj.

200. Subjekti ka shpjeguar<sup>122</sup> se tatimet mbi të ardhurat e qirasë janë paguar prej tij, duke vendosur në dispozicion mandatet përkatëse bankare, ku provohen pagesat e kryera në llogari të Ministrisë së Financave/Drejtorisë së Përgjithshme Tatimore.

201. Të ardhurat nga qiradhënia të deklaruara nga subjekti për periudhën 2011 – 2018 gjenden të trajtuara tek rubrika e “të ardhurave” në vijim të këtij vendimi.

### **Konstatime të Komisionit**

---

<sup>115</sup>Gjendja *cash* e vitit 2015.

<sup>116</sup>Gjendja *cash* e pakësuar për blerjen e garazheve.

<sup>117</sup>Gjendja *cash* e pakësuar për blerjen e automjetit.

<sup>118</sup>Gjendja *cash* e pakësuar për krijimin e gjendjes së llogarisë në emër të znj. E.P pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 1.080.498 lekë.

<sup>119</sup>Gjendja *cash* e vitit 2016

<sup>120</sup>Gjendja *cash* e mbartur nga viti 2011.

<sup>121</sup>Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti, ndër të tjera, ka depozituar: (1) aktmarrëveshjen për dhënie me qira, datë 3.1.2013, midis qiradhënësit Erion Pano dhe qiramarrësit L.F, administrator i shoqërisë “F” sh.p.k., për periudhën janar 2013 – dhjetor 2013; mandatin bankar “urdhër transfertë e brendshme”, e lëshuar në datën 29.12.2017 nga “ProCredit Bank”; (2) aktmarrëveshjen për dhënie me qira, datë 3.1.2014, midis qiradhënësit Erion Pano dhe qiramarrëses “L.F” person fizik, me periudhë 1-vjeçare; mandatdepozitë për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e lëshuar në datën 12.2.2016, nga “Alpha Bank”; urdhërpaguese, tatim mbi të ardhurat individuale e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, për periudhën tatimore janar – dhjetor 2014; (3) aktmarrëveshjen për dhënie me qira, datë 3.1.2015, midis qiradhënësit Erion Pano dhe qiramarrëses “L.F” person fizik, me periudhë 1-vjeçare; mandatdepozitë për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e lëshuar në datën 9.1.2017 nga “Alpha Bank”; urdhërpaguesë, tatim mbi të ardhurat individuale, e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve për periudhën tatimore janar – dhjetor 2015; (4) aktmarrëveshjen për dhënie me qira, datë 29.3.2016, midis qiradhënësit Erion Pano dhe qiramarrësit “Xh.F” person fizik, me periudhë mars 2016 – mars 2018; mandat depozite për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e lëshuar në datën 28.3.2017 nga “Alpha Bank”; urdhërpaguese, tatim mbi të ardhurat individuale, e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve për periudhën tatimore janar – dhjetor 2016; derdhje për Segmentin e Taksave, në llogarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e lëshuar nga “Raiffeisen Bank” në datën 20.4.2018; urdhërpaguese, tatim mbi të ardhurat individuale, e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve për periudhën tatimore janar – dhjetor 2017.

<sup>122</sup>Në përgjigje të pyetësorit standard dhe në përgjigje të pyetësorit datë 14.10.2021.

202. Komisioni ka analizuar burimet e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting*, që kanë shërbyer për krijimin e kursimit *cash* në shumën 7.000 euro, ku nga analiza e kryer ka rezultuar një balancë negative në shumën 383.551 lekë për vitin 2016.

203. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Kushtetutës.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

204. Subjekti, në prapësime të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se mënyra e plotësimit të deklaratave periodike vjetore pas vitit 2011 është e saktë. Në mënyrë të përmbledhur subjekti ka argumentuar se në vitin 2012 nuk ka pasur kursime në gjendje *cash*, por vetëm mbartje të gjendjes *cash* prej 50.000 lekësh nga viti 2011, gjendje e cila ka vijuar deri në vitin 2014.

205. Në lidhje me konstatimet e Komisionit se në procesverbalin e datës 8.3.2016, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, ka referuar shumën 1.100.000 lekë si gjendje *cash* në datën 31.12.2014, subjekti ka shpjeguar se kjo shume ka qenë pjesë e të ardhurave vjetore të vitit 2014, e cila është përdorur për të shlyer huat e marra. Konkretisht, në DPV/2014, në seksionin e “detyrimeve financiare”, ka deklaruar *kontratë huamarrjeje nr. \*\*\*, datë 12.12.2008... shlyer 1.000 euro dhe kontratë huamarrjeje nr. \*\*\*, datë 27.9.2011... shlyer 1.200.000 lekë*. Sipas subjektit, kjo shumë nuk ka qenë gjendje *cash* më 31.12.2014, pasi i ka shpenzuar brenda atij viti për të shlyer pjesërisht huat. Ky ka qenë edhe kuptimi/konceptimi i subjektit në atë kohë për deklarimin e shumës 1.100.000 lekë, duke menduar që do të ishte më i qartë nëse do të deklaronte mundësitë financiare për likuiditete gjatë vitit 2014.

206. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se gjendja *cash* në vitin 2016 ka qenë 927.300 lekë, e cila rrjedh nga 500.000 lekë (*cash* i deklaruar në vitin 2015) – 120.700 lekë (pakësim *cash* për blerjen e garazheve) – 180.000 lekë (pakësim *cash* për blerjen e automjetit) – 22.000 lekë (*cash* i pakësuar për krijimin e gjendjes së llogarisë në emër të znj. E.P në “Raiffeisen Bank” në shumën 1.080.498 lekë) + 700.000 lekë (gjendja *cash* për vitin 2016) + 50.000 lekë (*cash* i mbartur nga vitit 2011). Kjo shumë në ditët e para të janarit është konvertuar në euro dhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka pasur gjendje *cash* në banesë shumën 7.000 euro.

207. Lidhur me balancën negative të rezultuar në vitin 2016, subjekti është ndalur tek shpenzimet e udhëtimit të llogaritura për këtë vit, duke pretenduar se për udhëtimin e realizuar në datat 18.6.2016 – 25.6.2016, me destinacion Antalia, Turqi, ka pasur një shpenzim prej rreth 1.000 euro, si të deklaruar në përgjigje të pyetësorit standard. Për të dokumentuar këtë shpenzim subjekti nuk ka mundur të gjejë një dokument provues, pasi ka qenë një ofertë promociionale.

208. Subjekti ka argumentuar se, nëse do të kryet një lexim logjik dhe aritmetik i balancave financiare të familjes së tij në vitet 2012 – 2015, jo vetëm që dalin me teprica në vlera të konsiderueshme, por referojnë dhe një konstante të shpenzimeve familjare mbi standardin e mbajtur nga ILDKPKI-ja dhe INSTAT-i, ku specifikisht viti 2015 del me një balancë pozitive në shumën 317.704 lekë. Në vijim, subjekti ka argumentuar se kjo balancë pozitive nuk është deklaruar si kursim *cash*, por është shpenzuar si shpenzim familjar gjatë vitit 2016. Duke qenë se periudha e deklarimit vjetor kryhej pikërisht brenda tremujorit të parë të çdo viti pasardhës dhe deklarimet për vitin 2015 bëhen brenda periudhës janar – mars të vitit 2016, shuma 317.704 lekësh e kursyer nga viti 2015, që në fillim të vitit 2016 ishte

vendosur për t'u përdorur për shpenzime familjare. Për rrjedhojë, viti 2016 do të dilte me një balancë negative në vlerën 61.550 lekë.

### **Vlerësimi i Komisionit**

209. Trupi gjykues, pasi analizoi prapësimet e subjektit të depozituara në datën 16.11.2022, në vijim të argumentimit dhe analizës logjike të kryer sa më sipër lidhur me deklarin e kursimeve *cash*, çmoi t'i konsiderojë bindëse shpjegimet e subjektit, për sa kohë pasaktësitë në deklarin nuk kanë shërbyer si shkak apo burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër prej tij, çka krijon bindjen se këto pasaktësi janë të paqëllimshme dhe se deklarinet e subjektit në deklaratën *Vetting* ndihmojnë për të kuptuar drejt deklarinet e tij ndër vite.

210. Sa i përket, pretendimit të subjektit lidhur me shpenzimet e udhëtimit në vitin 2016, trupi gjykues çmon të mos e marrë në konsideratë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë prove konkrete për të vërtetuar këtë pretendim, i cili mbeti në nivel deklarativ. Për këtë arsye, vlera e shpenzimeve të udhëtimeve e pasqyruar në analizën financiare të Komisionit mbetet e pandryshuar.

211. Komisioni i vlerëson jo bindëse shpjegimet e subjektit, se balanca pozitive e rezultuar në vitin 2015 është shpenzuar gjatë vitit 2016, pasi ky deklarin bie në kundërshtim me detyrimin e tij ligjor për deklarin me saktësi të pasurisë dhe interesave privatë, gjendjen e likuiditeteve bankare dhe *cash*, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

212. Komisioni ka rishikuar analizën financiare për vitin 2016, duke konsideruar gjendjen e kursimeve *cash* të saktësuar nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në prapësimet e tij, ku përfundimisht nga analiza e kryer, referuar tabelës së përgjithshme, subjekti do të rezultonte me një balancë negative në shumën 361.551 lekë. Përfundimisht, trupi gjykues çmon se në raport edhe me deklarinet e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, kjo balancë negative është në një masë të tillë që nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit me aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **213. Llogari page në shumën 973 lekë në “Credins Bank”, në emër të subjektit**

214. Nga informacioni i ardhur nga “Credins Bank”<sup>123</sup> konfirmohet llogaria e pagës në emër të z. Erion Pano nga momenti i çeljes së llogarisë, si dhe gjendja e saj, e cila përputhet me deklarinet e subjektit.

215. Nga hetimi i kryer duket se deklarin i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

### **Verifikime të tjera të rezultuara gjatë hetimit administrativ**

216. Komisioni hetoi në lidhje me adresat e deklaruara ndër vite, të cilat i referohen banesave të marra në përdorim, pa kundërshtim, nga shtetasit A.V dhe A.R gjatë periudhës 2003 – 2010.

217. Nga hetimi i kryer nuk u evidentua ndonjë situatë konflikti interesi ndërmjet subjektit me pronarët e këtyre banesave, si dhe nuk u evidentuan problematika, pasi rezultuan të ishin blerë nga pronarët para se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit në vitin 2005.

### **Verifikimi i të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS**

<sup>123</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2020.

218. Në lidhje me udhëtimet e kryera nga subjekti jashtë territorit të vendit, automjetet dhe personat me të cilët ka udhëtuar, nga hetimi i kryer nuk u evidentuan problematika.

### **Lidhur me automjetet në përdorim**

219. Gjatë hetimit subjekti ka deklaruar përdorimin e një automjeti në vitin 2006, në pronësi të Fakultetit të Mjekësisë, si dhe një automjet në pronësi të kunatit të tij J.L, për përdorim 8-ditor, në gusht të vitit 2016.

220. Nga hetimi i Komisionit nuk u evidentuan problematika.

### **Në lidhje me një shpenzim mjekësor**

221. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar<sup>124</sup> një shpenzim mjekësor në shumën 20.000 euro, të kryer në prill të vitit 2017, të mbuluar nga siguracioni shëndetësor me shoqërinë e sigurimit “\*\*\*\*”, në Tiranë, për një ndërhyrje kirurgjikale të kryer në datën 18.4.2017 në Institutin Ortopedik R, B, Itali.

222. Subjekti ka deklaruar se këto shpenzime janë paguar nga shoqëria e sigurimit “\*\*\*\*”, në Tiranë, si rezultat i policës së sigurimit privat të shëndetit për individ dhe familjar me nr. serial \*\*\*, për periudhën 2017 – 2018.

223. Komisioni ka verifikuar procedurën e ndjekur për mbulimin e këtij shpenzimi spitalor nga shoqëria e sigurimeve “\*\*\*\*”<sup>125</sup>, e cila ka konfirmuar pagesën e kryer mbi dy polica sigurimi<sup>126</sup> në emër të subjektit, si dhe mbulimin e shpenzimit prej 20.000 euro me policën e sigurimit për aksidentet personale, me periudhë sigurimi 1.4.2017 – 31.3.2018, ku është paguar *prim* sigurimi 50 euro.

224. Nga aktet në dosje evidentohet transfertat bankare e kryer në datën 7.4.2017 nga shoqëria “\*\*\*\*” me përfitues spitalin italian për pagesën e shumës 20.000 euro.

225. Lidhur me shpenzimin spitalor, në dosje janë administruar dokumentet vijuese:

- vërtetim në gjuhën italiane<sup>127</sup> të lëshuar në datën 18.4.2017 nga Instituti Ortopedik i B, ku konfirmohet shtrimi i z. Erion Pano pranë këtij spitali në datën 18.4.2017;
- faturat<sup>128</sup> mbi shpenzimet spitalore të lëshuara në datën 2.5.2017, në vlerë totale 19.655 euro;
- vërtetim<sup>129</sup> nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2022, të lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*”, e cila vërteton kryerjen e pagesës së *primit* prej 50 euro në datën 1.4.2017 për Policën e Sigurimit nga Aksidentet Personale.

226. Nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi *TIMS* ka rezultuar se subjekti ka udhëtuar drejt shtetit italian në datën 17.4.2017 deri më 26.4.2017.

<sup>124</sup>Në përgjigje të pyetësorit standard.

<sup>125</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2022.

<sup>126</sup>(a) Polica për “sigurim shëndetësor familjar” me nr. police \*\*\*, në emër të subjektit, bashkëshortes dhe fëmijëve me periudhë sigurimi 10.4.2017 – 9.4.2018, ku është paguar *prim* sigurimi 800 euro; (b) polica për “sigurim nga aksidente personale” me nr. police \*\*\*, në emër të subjektit Erion Pano dhe bashkëshortes, me periudhë sigurimi 1.4.2017 – 31.3.2018, ku është paguar *prim* sigurimi 50 euro.

<sup>127</sup>Nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji (i përkthyer dhe noterizuar).

<sup>128</sup>Dokumentacion i depozituar nga subjekti me *email*-in e datës 9.3.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 1.3.2022: fatura nr. \*\*\*, datë 2.5.2017, në shumën 471,92 euro; fatura nr. \*\*\*, datë 2.5.2017, në shumën 1.391,85 euro; fatura nr. \*\*\*, datë 2.5.2017, në shumën 17.791,23 euro.

<sup>129</sup>Dokumentacion i depozituar nga subjekti përmes *email*-it datë 6.10.2022.

227. U hetua konflikti i interesit ne lidhje me shoqërinë e sigurimit dhe nga përgjigjet e ardhura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>130</sup> nuk rezultoi ndonjë e dhënë ku subjekti të gjendej në ndonjë nga rastet e parashikuara në ligj.

### **Konstatime të Komisionit**

228. Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se pagesa nga shoqëria e sigurimit është kryer në datën 7.4.2017 dhe shërbimi spitalor rezultoi i kryer në datën 18.4.2017, nga ku duket se subjekti ka përfituar një trajtim preferencial nga shoqëria e sigurimeve “\*\*\*\*”. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit subjektit iu kërkuan shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime**

229. Në prapësimet e tij, subjekti ka shpjeguar se është siguruar pranë shoqërisë “\*\*\*\*” nëpërmjet policës së sigurimit për “aksidentet personale”, me periudhë sigurimi 1.4.2017 - 31.3.2018 dhe si pasojë e një aksidenti (rrëzimi) që i ka ndodhur në datën 3.4.2017 (me sa mban mend) ka pësuar dëmtime në regjionin kokso-femoral. Pas konsultës me mjekë ortopedë duhej t’i nënshtrohej sa më shpejt një ndërhyrje kirurgjikale, pasi ekzistonte rreziku i një pasoje më të rëndë për shëndetin.

230. Kjo ndërhyrje për shkak të mungesës së eksperiencës nuk mundësohej në nivelin e duhur në Shqipëri dhe, për rrjedhojë, subjekti ka komunikuar me të afërm rezidentë në qytetin e Bolonjës, Itali, të cilët i kanë sugjeruar Institutin Ortopedik R. Pas marrjes së informacionit të duhur, subjekti ka vënë në dijeni shoqërinë e sigurimeve “\*\*\*\*”, të cilët, në funksion të policës së sigurimit datë 1.4.2017, “Për aksidentet personale”, komunikuan me Institutin Ortopedik dhe vijuan procedurat përkatëse, duke mbuluar shpenzimet spitalore.

321. Subjekti ka shpjeguar se, duke qenë brenda periudhës së sigurimit, ka ndjekur të gjitha hapat përkatëse për t’u dëmshpërblyer sipas ligjeve dhe rregulloreve mbi të cilat operojnë shoqëritë e sigurimit dhe gjithë procedura e ndjekur është mbështetur në të drejtat dhe detyrimet e paracaktuara në policën e sigurimit dhe nga ana e shoqërisë në asnjë moment nuk është ngritur pretendim sa i përket rastit të tij. Subjekti ka depozituar shkresën nr. \*\*\*prot., datë 8.11.2022, ku shoqëria e sigurimit konfirmon se procedura e ndjekur në vitin 2017 për dëmshpërblimin e të siguruarit Erion K Pano është kryer sipas ligjeve dhe rregulloreve të brendshme, ashtu si për çdo të siguruar tjetër, dhe nuk është evidentuar asnjë shkelje apo çfarëdo parregullsie lidhur me të nga auditet e jashtme apo të brendshme. Në vijim, subjekti ka argumentuar se polica e sigurimit sipas përkufizimit të Kodit Civil (neni 690) është një akt autentik ligjor, që ka fuqinë e ligjit për palët që e nënshkruajnë dhe, në rastin konkret, me shpenzimet spitalore të realizuara, shoqëria “\*\*\*\*” ka përmbushur detyrimin e lindur nga një marrëdhënie kontraktore sipas ligjit në fuqi. Për të gjitha sa më sipër, nuk ekziston asnjë element që sipas përkufizimit të nenit 23 (ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar) do të përbënte trajtim preferencial.

### **Vlerësimi i Komisionit**

232. Komisioni, duke mbajtur në vëmendje standardet e Etikës, të cilat nuk zbatohen vetëm në përmbushjen e detyrave të gjyqësorit dhe prokurorisë, por gjithashtu mbulojnë sjelljen në jetën private dhe aktivitetet jashtëgjyqësore. Për këtë arsye u krye një hetim i thellë në drejtim të procedurës së ndjekur për mbulimin e këtij shpenzimi nga shoqëria e sigurimeve “\*\*\*\*”, si dhe u verifikua për ndonjë konflikt të mundshëm interesi midis subjektit dhe shoqërisë së sigurimit, ku nga hetimi i kryer nuk u rezultoi të ishte kryer ndonjë shkelje në

<sup>130</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2022.

procedurat e ndjekura nga shoqëria e sigurimit dhe nuk rezultoi që subjekti të gjendej në ndonjë nga situatat e konfliktit të interesit të parashikuara në ligj.

233. Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të subjektit, si dhe nga analiza e provave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi, vëren se shpjegimet e subjektit janë të paqarta lidhur me faktet dhe rrethanat e ngjarjes, nga ku duket si një përfitim në favor të tij. Përfundimisht vlerëson se ky qëndrim i subjektit nuk është në përputhje me etikën e magjistratit, pavarësisht faktit se nuk u provua që ky trajtim të lidhej me detyrën e tij, por e parë si një mënyrë sjelle, e cila qëndron brenda indikatorit të Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, në përputhje me parashikimin e pikave 3 e 4 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, magjistrati duhet të tregojë kujdesin e duhur, për të mos cënuar paanësinë e tij, si një tregues që lidhet me burime të tjera vlerësimi.

### **Shpenzimet e shkollimit të fëmijëve**

234. Komisioni ka hetuar mbi shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të subjektit, ku nga hetimi<sup>131</sup> i kryer ka rezultuar se vajza e subjektit D.P nuk është e regjistruar në institucionet e arsimit parauniversitar, ndërsa lidhur me shpenzimet e djalit F.P ka kërkuar informacion pranë institucioneve përkatëse: kolegji greko-shqiptar “A”, Tiranë<sup>132</sup>, ka konfirmuar shkollimin e djalit të subjektit F.P pranë këtij kolegji për periudhën 2011 – 2016, ku totali i pagesës për mësimdhënie gjatë gjithë periudhës së shkollimit është 7.750 USD, ndërsa totali i pagesës transport-kancelari gjatë kësaj periudhe është 308.000 lekë; “A.C.T”<sup>133</sup> ka konfirmuar se F.P ka frekuentuar këtë shkollë në vitet akademike përkatëse nga viti 2016 e në vazhdim, si dhe pagesat e kryera çdo vit.

235. Në analizë financiare janë përfshirë shpenzimet e dokumentuara mbi shkollimin e fëmijëve të subjektit.

### **Të ardhurat nga qiradhënia<sup>134</sup> e truallit të ndodhur në rrugën “H.K”, Tiranë**

<sup>131</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020, të Ministrisë së Arsimit.

<sup>132</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2020.

<sup>133</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2020.

<sup>134</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) aktmarrëveshje datë 6.6.2011, për dhënie me qira të një sipërfaqe truall në rr. “H.K”, nr. \*\*, për periudhën qershor 2011 – dhjetor 2011, në shumën 20.000 lekë/muaj, me qiradhënës Erion Pano dhe qiramarrës L.F, administrator i shoqërisë “F” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*H (sipas kontratës rezulton 6 muaj x 20.000 lekë = 120.000 lekë); (2) aktmarrëveshje datë 1.12.2011, për dhënie me qira të një sipërfaqe truall në rr. “H.K”, nr. \*, me afat njëvjeçar, në shumën 50.000 lekë/muaj, me qiradhënës Erion Pano dhe qiramarrës L.F, administrator i shoqërisë “F” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*H (sipas kontratës rezulton 3 muaj x 50.000 lekë = 150.000 lekë); (3) aktmarrëveshje datë 1.3.2012, për dhënie me qira të një sipërfaqe truall në rr. “H.K”, nr. \*, me afat mars 2012 deri në fund të muajit dhjetor 2012, në shumën 80.000 lekë/muaj, me qiradhënës Erion Pano dhe qiramarrës L.F, administrator i shoqërisë “F” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*H (sipas kontratës rezulton 10 muaj x 80.000 lekë = 800.000 lekë); (4) aktmarrëveshje datë 3.1.2013, për dhënie me qira të një sipërfaqe truall në rr. “H. K”, nr. \*, me afat janar 2013 deri në fund të muajit dhjetor 2013, në shumën 80.000 lekë/muaj, me qiradhënës Erion Pano dhe qiramarrës L.F, administrator i shoqërisë “F” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*H (sipas kontratës 12 muaj x 80.000 lekë = 960.000 lekë); (5) aktmarrëveshje datë 3.1.2014, për dhënie me qira të një sipërfaqe truall në rr. “H.K”, nr. \*, me afat njëvjeçar, në shumën 80.000 lekë/muaj, me qiradhënës Erion Pano dhe qiramarrës L. F, administrator i shoqërisë “F” sh.p.k., me NIPT L\*\*\*A (sipas kontratës 12muaj x 80.000 lekë = 960.000 lekë); (6) aktmarrëveshje datë 3.1.2015, për dhënie me qira të një sipërfaqe truall në rr. “H.K”, nr. \*, me afat njëvjeçar, në shumën 80.000 lekë/muaj, me qiradhënës Erion Pano dhe qiramarrës L.F, administrator i shoqërisë “F” sh.p.k., me NIPT L\*\*\*A (sipas kontratave rezulton 10 muaj x 80.000 lekë = 800.000 lekë); (7) aktmarrëveshje datë 29.10.2015, për dhënie me qira të një sipërfaqe truall në rr. “H.K”, nr. \*\*, me afat 6-mujor, në shumën 80.000 lekë/muaj, me qiradhënës Erion Pano dhe qiramarrësit Xh.F, me NIPT L\*\*\*A (sipas kontratës rezulton 5 muaj x 80.000 lekë = 400.000 lekë); (8) aktmarrëveshje datë 29.3.2016, për dhënie me qira të një sipërfaqe truall në rr. “H.K”, nr. \*, me afat për periudhën mars 2016 – mars 2018, në shumën 80.000 lekë/muaj, me qiradhënës Erion Pano dhe qiramarrës Xh.F, me NIPT L\*\*\*A (sipas kontratës rezulton deri në datën 31.12.2016/9 muaj x 80.000 lekë = 720.000 lekë); (9) faturë pagese në “ProCredit Bank”, tatim qiraje e datës 24.12.2012, për periudhën 6.6.2011 – 31.12.2011 nga shoqëria “F” sh.p.k. në shumën 17.000 lekë; (10) faturë pagese tatim qiraje e datës 24.12.2012, për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2012, nga shoqëria “F” sh.p.k. në shumën 90.000 lekë; (11) faturë pagese tatim qiraje datë 29.12.2014, për vitin 2013, nga shoqëria “F” sh.p.k. në shumën 96.000 lekë; (12) urdhërpagese \*\*\*, tatim mbi të ardhurat individuale për periudhën tatimore janar 2014 – dhjetor 2014,



236. Komisioni ka kërkuar informacion pranë institucioneve përkatëse, si vijon:

237. ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri<sup>135</sup> ka konfirmuar pasurinë truall me sip. 257 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*, vol. \*\*, f. \*\*, Tiranë, të regjistruar në bashkëpronësi të subjektit Erion Pano, i cili zotëron 1/3 pjesë takuese të pasurisë.

238. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë<sup>136</sup> ka informuar se nga verifikimi i të dhënave në sistemin C@TS, kontabilitet dhe arkiv, z. Erion Pano është i regjistruar pranë kësaj Drejtorie për përgjegjësinë tatimore Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave për vitet 2014 – 2019, ku evidentohen deklaratimet e subjektit mbi të ardhurat e qirasë.

239. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë<sup>137</sup> ka informuar se nga verifikimi i të dhënave në sistemin C@TS, kontabilitet dhe arkivit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, se:

- a) *Subjekti “F” sh.p.k.* ka bërë pagesa tatim në burim mbi qiranë për periudhën 1.12.2011 – 1.12.2012, mars 2012 – dhjetor 2012 dhe janar 2013 – dhjetor 2013, por nuk mund të përcaktojnë për kë kontratë janë bërë këto pagesa.
- b) *Subjekti “L.F”, person fizik*, për periudhën 29.10.2015 – 29.4.2016 nuk ka bërë pagesa tatim në burim mbi qiranë, ndërsa për periudhën 3.1.2015 – 3.1.2016 ka bërë pagesa tatim në burim mbi qiranë.
- c) *Subjekti “Xh.F”, person fizik*, për periudhat 29.10.2015 – 29.4.2016 dhe 29.3.2016 – 29.3.2018 nuk është i regjistruar për përgjegjësinë tatimore tatim në burim dhe nuk ka bërë pagesa tatim në burim mbi qiranë.

#### **Faktet e rezultuara nga hetimi i kryer**

240. Nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti Erion Pano ka dhënë me qira një sipërfaqe trualli, të ndodhur në rrugën “H.K”, Tiranë, me qëllim shfrytëzimin e saj për aktivitet “treg fruta-perime” nga qiramarrësit: (a) shoqëria “F” sh.p.k., me administrator z. L.F, për periudhën 6.6.2011 – dhjetor 2013; (b) “L.F”, person fizik, për periudhën nga janar 2014 – janar 2016; (c) “Xh.F”, person fizik. për periudhën mars 2016 – janar 2021.

241. Subjekti ka depozituar aktmarrëveshjet<sup>138</sup> e qirasë të nënshkruara midis tij dhe qiramarrësve të sipërpërmendur nga viti 2011 deri aktualisht, të shoqëruara me mandatet

---

në shumën 96.000 lekë (bashkëlidhur faturë pagese në “Alpha Bank”; (13) faturë pagese në “Alpha Bank” e tatimit mbi të ardhurat për qiranë, periudha janar – dhjetor 2015, në shumën 144.000 lekë.

<sup>135</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2022.

<sup>136</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020.

<sup>137</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021.

<sup>138</sup>Dokumentacion i depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard, regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2020: (1) aktmarrëveshje për dhënie me qira, datë 6.6.2011; (2) aktmarrëveshje për dhënie me qira datë 1.12.2011; mandat bankar “urdhër transfertë e brendshme”, datë 24.12.2012, nga “ProCredit Bank”; (3) aktmarrëveshje për dhënie me qira datë 1.3.2012; mandat bankar “urdhër transfertë e brendshme”, datë 30.7.2013, nga “ProCredit Bank”; (4) aktmarrëveshje për dhënie me qira, datë 3.1.2013; mandat bankar “urdhër transfertë e brendshme”, datë 29.12.2017, nga “ProCredit Bank”; (5) aktmarrëveshje për dhënie me qira datë 3.1.2014; mandat depozite për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, lëshuar në datën 12.2.2016 nga “Alpha Bank”; urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve për periudhën tatimore janar – dhjetor 2014; (6) aktmarrëveshje për dhënie me qira, datë 3.1.2015; mandat depozite për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, lëshuar në datën 9.1.2017 nga “Alpha Bank”; urdhër pagese, tatim mbi të ardhurat individuale e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, për periudhën tatimore janar – dhjetor 2015; (7) aktmarrëveshje për dhënie me qira, datë 29.3.2016; mandat depozite për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e lëshuar në datën 28.3.2017 nga “Alpha Bank”; urdhërpagese tatim mbi të ardhurat individuale e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, për periudhën tatimore janar – dhjetor 2016; derdhje për segmentin e taksave, në llogarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e lëshuar nga “Raiffeisen Bank” në datën 20.4.2018; urdhërpagese tatim mbi të ardhurat individuale e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, për periudhën tatimore janar - dhjetor 2017; (8) aktmarrëveshje për dhënie me qira datë 29.3.2018; mandat bankar “derdhje për të tretët” në llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e lëshuar nga “OTP Bank” në datën 16.4.2019; urdhërpagese, tatim mbi të ardhurat individuale e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve, për

përkatëse bankare, ku provohet se pagesa e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e qirasë janë kryer nga vetë subjekti.

242. Nisur nga fakti se prona e dhënë me qira është një pasuri në bashkëpronësi, ku subjekti zotëron 1/3 e pjesës takuese të truallit prej 257 m<sup>2</sup> dhe nisur nga fakti se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia në shumën 4.910.000 lekë për periudhën 2011 – 2018, Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësojë sipërfaqen e dhënë me qira për truallin në bashkëpronësi, si dhe të ardhurat e përfituara nga kjo qiradhënie, nëse i përkasin vetëm pjesës së tij takuese (1/3 pjesë) apo të gjithë trashëgimtarëve.

243. Subjekti ka shpjeguar<sup>139</sup> se sipërfaqja e truallit të dhënë me qira është 257 m<sup>2</sup> dhe të ardhurat e deklaruara prej tij në shumën 4.910.000 lekë janë përfitur vetëm prej tij *cash*.

244. Gjatë hetimit subjekti ka depozituar<sup>140</sup> deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 14.4.2022, ku shtetaset M.P (nëna) dhe D.P(motra), ndër të tjera, kanë deklaruar se *në maj të vitit 2011 Erion Pano ka kërkuar mendimin e tyre për lënien me qira të truallit 257 m<sup>2</sup> dhe duke qenë se Erioni kishte nevojë për të ardhura financiare, pasi kishin rreth 1 vit që ishin vendosur me banim në apartamentin në shlyerje e sipër të detyrimeve me firmën ndërtuese, si një sjellje tipike e solidaritetit familjar, kanë dakordësuar se të gjitha të ardhurat e qirasë të përfitoheshin prej tij.*

245. Përmes kësaj deklarate, nëna dhe motra e subjektit deklarojnë se prej vitit 2011 deri në vitin 2019 të ardhurat nga qiraja janë përfitur të plotë vetëm nga z. Erion Pano dhe prej vitit 2020 deri aktualisht subjekti nuk është më përfitues i të ardhurave nga qiraja, pasi sipas aktmarrëveshjes përkatëse me qiradhënësin këto të ardhura përfitohen nga shtetaset M dhe D.P.

246. Në lidhje me të ardhurat nga qiraja, sipas akteve të administruara në dosje rezulton e provuar se subjekti ka përfitur të ardhurat nga qiraja dhe ka paguar detyrimet tatimore në masë të plotë, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

## **TË DHËNA KONFIDENCIALE**

**247. Huamarrje në shumën 3.000.000 lekë**, me palë huadhënëse N.M dhe huamarrës Erion Pano. Shuma e detyrimit financiar i është shlyer huadhënësit ndër vite dhe e plotë në datën 12.10.2016, siç evidentohet në deklaratën noteriale nr. \*\*\*.

248. Subjekti ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore për vitet 2011 – 2016 shumën e huas prej 3.000.000 lekësh, si dhe shlyerjet e kryera çdo vit deri në kthimin e plotë të saj.

249. Në analizën financiare është reflektuar kthimi i huas sipas deklarimeve në DPV (shihni tabelën përmbledhëse të paraqitur në këtë vendim).

**250. Huamarrje në shumën 10.000 euro**, me palë huadhënëse A.V dhe huamarrës Erion Pano. Shuma e detyrimit financiar i është shlyer huadhënësit ndër vite dhe e plotë në datën 12.12.2014, si dhe evidentohet në deklaratën noteriale nr. \*\*\*.

251. Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit në periudhën 2008 – 2014, evidentohet se subjekti ka deklaruar huan prej 10.000 euro, si dhe shumat e shlyera çdo vit deri në kthimin e plotë të saj.

---

periudhën tatimore janar - dhjetor 2018; (9) aktmarrëveshje për dhënie me qira datë 1.1.2019; (10) certifikatë regjistrimi i personit të tatueshëm "F" sh.p.k., e lëshuar nga QKB-ja në datën 9.6.2011.

<sup>139</sup> Shpjegimet e subjektit me *email*-in e datës 31.10.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 14.10.2021.

<sup>140</sup> Dërguar nga subjekti me *email*-in e datës 15.4.2022.

252. Në analizën financiare janë reflektuar kthimet e huas sipas deklarimeve në vite.

#### Analiza financiare e përgjithshme për periudhën 2001 – 2016

VITET	PASURI	DETYRIME	PASURI NETO	TË ARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI
<b>10/2001- 2003</b>	500 000	-	500 000	988 708	187 858	<b>300 850</b>
<b>2004</b>	173 958	-	173 958	1 151 337	369 249	<b>608 130</b>
<b>2005</b>	456 345	-	456 345	1 202 637	435 115	<b>311 177</b>
<b>2006</b>	876 134	-	876 134	1 441 663	682 692	<b>- 117 163</b>
<b>2007</b>	823 683	-	823 683	1 581 715	536 816	<b>221 217</b>
<b>2008</b>	1 758 573	1 631 825	126 748	1 546 207	829 020	<b>590 439</b>
<b>2009</b>	872 242	-	872 242	1 901 042	650 388	<b>378 412</b>
<b>2010</b>	395 903	-	395 903	1 567 391	857 483	<b>314 005</b>
<b>2011</b>	2 729 832	2 585 100	144 732	1 979 623	922 441	<b>912 450</b>
<b>2012</b>	6 985	- 1 198 600	1 205 585	2 408 153	877 286	<b>325 282</b>
<b>2013</b>	426 691	- 840 210	1 266 901	2 581 656	970 510	<b>344 245</b>
<b>2014</b>	- 410 082	- 1 340 110	930 028	2 557 825	1 280 630	<b>347 167</b>
<b>2015</b>	927 386	- 500 000	1 427 386	3 098 961	1 353 871	<b>317 704</b>
<b>2016</b>	2 111 856	- 100 000	2 211 856	3 905 168	2 054 863	<b>- 361 551</b>

**253. Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2001 – 2016, subjekti paraqitet me balanca negative të shtrira në dy vite, përkatësisht për vitet 2006 dhe 2016, në shumën totale 478.713 lekë.**

#### Vlerësimi përfundimtar i kriterit pasuror

254. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Erion Pano ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në deklaratën *Vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit. Veç këtyre, për një vlerësim pozitiv të kriterit pasuror, Komisioni çmon me rëndësi faktin se në lidhje me këtë subjekt rivlerësimi janë kryer hetime të thelluara edhe për deklarime të kryera pas deklaratës *Vetting*, pikërisht në funksion të krijimit të bindjes së brendshme në lidhje me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve të kryera para kësaj deklarate nga ana e subjektit dhe personave të lidhur. Nga hetimet rezultoi se çdo deklaram pas deklaratës *Vetting* ka qenë në koherencë të plotë dhe në vijueshmëri të deklarimeve që nga viti 2005, kur subjekti ka rifilluar të ushtrojë detyrën e prokurorit, e deri në deklaratën *Vetting*.

#### B. KONTROLLI I FIGURËS

255. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

256. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit një raport<sup>141</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në përfundim të veprimeve verifikuese, përfundimisht DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të z. Erion K Pano.

### **Vlerësimi i Komisionit**

257. Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga DSIK-ja në vitin 2017, për të cilën nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin Erion Pano.

258. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

259. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit Erion Pano arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

260. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit<sup>142</sup> të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

261. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënave nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe sektori i protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme.

262. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon:

<sup>141</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.10.2021, të KDZH-së.

<sup>142</sup> Raporti i miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.12.2021, të KLP-së.

## **i. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit**

263. Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore**

264. Subjekti i rivlerësimit Erion Pano ka deklaruar se për periudhën tetor 2013 – tetor 2016 ka ushtruar funksionin e zëvendës drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **ii. Analizimi i dosjeve të përzgjedhura me short**

265. Gjatë periudhës së vlerësimit prokurori Erion Pano ka qenë me detyrën e zëvendës drejtuesit dhe për këtë periudhë nuk ka prodhuar akte të cilat janë kërkuar në formularin e vetë deklarimit.

266. Për këtë arsye janë analizuar tri dokumente ligjore jashtë kësaj periudhe, si dhe pesë dosje të përzgjedhura në mënyrë rastësore (dy akte ligjore apelim, dy vendime shfuqizimi dhe një vendim zëvendësimi).

267. Nga dosjet e vëzhguara nuk u konstatuan problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional të subjektit Erion Pano, në cilësinë e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **iii. Të dhënat nga burime arkivore të KLP-së**

268. Nga verifikimi i të dhënave në arkivin e KLP-së nuk rezulton që prokurori Erion Pano të ketë marrë masa disiplinore.

269. Nga informacioni i dërguar nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para kanë rezultuar 3 procedime penale të regjistruara ndaj subjektit të rivlerësimit Erion Pano, trajtuar si në vijim:

**270. Një procedim penal është regjistruar në vitin 2014** në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në bazë të kallëzimit nr. \*\*\*, datë 3.10.2014, të shtetasit G. Sh ndaj tre prokurorëve, midis të cilëve edhe subjekti Erion Pano, për veprën penale “shpërdorim detyre dhe veprime arbitrare”<sup>143</sup>. Ky shtetas pretendon se prokurorët kanë vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2010, ndërsa nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur vazhdimi i hetimeve. Në përfundim të veprimeve hetimore është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

271. Komisioni ka administruar dosjen përkatëse penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>144</sup> me qëllim verifikimin e veprimeve hetimore të kryera nga subjekti, ku ka rezultuar si vijon:

### **Rrethanat e faktit**

272. Në datën 25.1.2010 shtetasi G.Sh, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “K” sh.p.k., ka kryer kallëzim penal ndaj punonjësit të tij Y.F për mashtrim, me pretendimin se ky i fundit në dhjetor të vitit 2009 ishte autorizuar për të blerë një sasi pajisjesh kompjuterike në Kinë, të cilat kanë rezultuar me defekte, mungesë aksesorësh dhe mospërbushje e parametrave teknikë.

<sup>143</sup>Të parashikuara në nenet 248 dhe 250 të Kodit Penal.

<sup>144</sup>Dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2022.

273. Për këtë çështje, prokurori Erion Pano ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* në datën 8.2.2010, për veprën penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal dhe në përfundim të hetimeve, në datën 30.7.2010 subjekti ka vendosur pushimin e çështjes me argumentin se nuk rezultojnë elementët e veprës penale të mashttrimit, pasi përgjegjësia për shkaktimin e dëmit është një çështje civile e cila rregullohet nga Kodi Civil, për të cilën palët kanë një marrëdhënie kontraktore. Ky vendim i prokurorit është shfuqizuar me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 6.10.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të ankimit të kallëzuesit, duke i lënë detyra përkatëse organit të prokurorisë, si: thirrja dhe marrja në pyetje e kallëzuesit dhe e të kallëzuarit, i cili mohon të ketë një kontratë pune me shoqërinë; pyetjen e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit; si dhe kryerjen e një aktekspertimi teknik të njësive kompjuterike dhe ballafaqimin e shtetasve. Në zbatim të detyrave të caktuara nga gjykata, subjekti ka kryer veprimet hetimore, ku në përfundim të hetimit, në datën 18.12.2012 ka vendosur sërish pushimin e procedimit penal.

274. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kallëzuesi dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* regj., datë 8.5.2013, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* datë 17.12.2013, ka vendosur përsëri shfuqizimin e vendimit të pushimit, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve, me argumentin se detyrat e lëna nga Gjykata nuk janë zbatuar (si rithirrja dhe ripyetja e të kallëzuarit, ballafaqimi i tij me kallëzuesin) dhe prokurori nuk rezultoi të ketë marrë në shqyrtim kallëzimin, duke mos ju dhënë përgjigje të gjitha paqartësive të ngritura. Në vijim, çështja penale është hetuar nga një prokuror tjetër, i cili në datën 16.6.2014 ka vendosur pushimin e procedimit penal.

275. Në lidhje me konstatimet e gjykatës për hetim të paplotë, subjektit iu kërkuan shpjegime.

### **Shpjegimet e subjektit**

276. Në lidhje me konstatimet e gjykatës për hetim të paplotë, subjekti ka shpjeguar se në zbatim të detyrave të caktuara prej saj ka urdhëruar policinë gjyqësore të kryejë veprimet përkatëse. Pasi është njohur me veprimet procedurale të realizuara nga policia gjyqësore, nga shqyrtimi dhe verifikimi në tërësi i fakteve dhe provave ka arritur në përfundimin se hetimet në këtë procedim penal ishin të plota dhe duhet të pushoheshin me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

277. Lidhur me konstatimin e gjykatës se nuk është realizuar pyetja e të kallëzuarit e më tej ballafaqimi i tij me kallëzuesin, subjekti ka sqaruar se ka urdhëruar njoftimin e këtij shtetasi në mënyrë të përsëritur, sipas nenit 132 e vijues të Kodit Procedurës Penale (datë 10.7.2012, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2012, shkresa nr. \*\*\* prot., dhe datë 9.10.2012, shkresa nr. \*\*\* prot.) nëpërmjet shërbimeve të policisë, të cilët në datën 6.11.2012 kanë konfirmuar se pasi ishin realizuar të gjitha kërkimet nuk ishte bërë e mundur gjetja dhe njoftimi i shtetasit Y. F. Subjekti ka shpjeguar se pavarësisht se pyetja e të kallëzuarit nuk është realizuar, moskryerja e këtij veprimi procedural në vlerësimin e tij nuk ka sjellë asnjë pasojë konkrete në lidhje me pamjaftueshmërinë e veprimeve hetimore, që mund të kenë ndikuar në marrjen e vendimit.

278. Sa i përket konstatimit të gjykatës se nga ana e prokurorit nuk rezultoi që të jetë marrë në shqyrtim kallëzimi për sa i përket veprës penale të mashttrimit dhe prokuroria ka për detyrë të hetojë dhe të dalë në përfundim bazuar në nenet 290 dhe 328 Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka shpjeguar se ky konstatim nuk qëndron, pasi në vendimin e pushimit, datë 18.12.2012, ka analizuar dhe interpretuar vlerën provuese të provave, si dhe ka argumentuar shkaqet ligjore ku është mbështetur për të konkluduar se fakti nuk

parashikohet nga ligji si vepër penale (neni 328/1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale), pasi nuk plotësohen elementet kryesorë të anës subjektive dhe objektive. Subjekti pretendon se për këtë procedim penal janë realizuar të gjitha veprimet e mundshme hetimore, natyrisht brenda kuadrit të mjeteve për kërkimin e provës të parashikuar nga ligji.

279. Në vijim, kjo çështje penale është hetuar nga një prokuror tjetër, i cili në datën 16.6.2014 ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke përdorur të njëjtin argument si në vendimmarrjen e subjektit dhe për këtë vendim nuk rezulton të jetë bërë ankim nga kallëzuesi, pasi fashikulli i procedimit penal gjendet i arkivuar prej vitit 2014.

### **Vlerësimi i Komisionit**

280. Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në raport edhe me faktet e konstatuara, i çmon bindëse shpjegimet e tij, pasi nga analizimi i dosjes ka rezultuar të jetë thirrur disa herë paraqitja e të kallëzuarit, por nuk është bërë e mundur gjetja e tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se çështja penale nuk ka marrë zgjidhje, jo për shkak të një hetimi të mangët nga ana e subjektit, e cila mund të përbënte shkak për cenimin e aftësive profesionale të subjektit dhe cenim të besimit të publikut, por për shkak të rrethanave të tilla të cilat pengonin kryerjen e veprimeve të caktuara hetimore të urdhëruara nga gjykata. Përfundimisht, Komisioni çmon se në tërësi nuk ka pasur fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në cenimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**281. Procedimi penal i regjistruar në datën 23.9.2019**, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në bazë të kallëzimit nr. \*\*\* të vitit 2019 të shtetasit S.Ç<sup>145</sup> ndaj disa prokurorëve, midis të cilëve edhe subjekti Erion Pano, për veprën penale “shpërdorim detyre”<sup>146</sup>.

282. Kallëzuesi pretendon se prokurorët e kallëzuar prej tij kanë kryer shkelje të ligjit, ku për të favorizuar personat fajtorë kanë vendosur mosfillimin e procedimeve penale pa bërë asnjë verifikim apo hetim të plotë, të gjithanshëm dhe objektiv. Ndaj këtyre vendimeve kallëzuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka pranuar ankimet përkatëse, duke urdhëruar prokurorinë të fillojë procedimin penal dhe të kryejë detyra konkrete.

283. Në përfundim të hetimeve është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

284. Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme është administruar kallëzimi i shtetas L. P, e cila ka kallëzuar penalisht disa gjyqtarë, ish-gjyqtarë, oficerë të policisë gjyqësore dhe prokurorë midis të cilëve edhe prokurorin Erion Pano, me pretendimin se kanë konsumuar veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal dhe veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

285. Prokuroria e Përgjithshme në datën 18.12.2019 e ka dërguar këtë çështje për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e cila ka vendosur mosfillimin e procedimit. Ky vendim është shfuqizuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet të Rënda me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.11.2019.

---

<sup>145</sup>Ky shtetas ka paraqitur gjithashtu denoncim pranë Komisionit, i cila gjendet i trajtuar në seksionin “Denoncimet nga publiku”, në vijim të këtij vendimi.

<sup>146</sup>Të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

286. Nga informacioni i administruar nga Prokuroria dhe Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar<sup>147</sup> ka rezultuar se kjo çështje është dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e regjistruar pa emër me nr. \*\*\*, datë 20.12.2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

287. Pas përfundimit të hetimeve, në datën 11.1.2022 është dërguar në gjykatë kërkesa për pushimin e çështjes, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.4.2022, me argumentin se nga provat e administruara nuk rezulton të ketë asnjë provë apo *indicie* e shtetasve, funksionarë të drejtësisë, të kenë disponuar me vendime për shkak të marrjes/pranimit të drejtpërdrejtë dhe/ose tërthorazi një përfitim për vete ose të tjerët.

288. Ky vendim gjyqësor është prishur nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.6.2022, ka vendosur kthimin e akteve Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

289. Kjo çështje penale është në gjykim e sipër nga Gjykata e Lartë Tiranë, me rekurs të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

290. Komisioni ka administruar dosjen përkatëse penale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>148</sup>, me qëllim verifikimin e veprimeve hetimore të subjektit. Nga verifikimi i kryer nuk u evidentuan problematika lidhur me veprimet hetimore të kryera nga subjekti.

## **ANALIZA E GJETJEVE**

291. Sipas kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga analizimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short ka rezultuar se:

### **Aftësitë profesionale**

292. Nga dosjet e vëzhguara prokurori Erion Pano shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit dhe ka të qartë kualifikimin ligjor të veprës penale, tregon kujdes në vlerësimin e situatave procedurale dhe identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Subjekti shfaq aftësi në arsyetim ligjor, të cilin e mbështet jo vetëm në normat penale, por edhe në ligje të tjera specifike. Aktet e përgatitura prej tij paraqiten të strukturuar, ku analizohen rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura si dhe qëndrimi logjik mbi zgjidhjen ligjore.

### **Aftësitë organizative**

293. Subjekti për periudhën e rivlerësimit ka ndjekur dhe ka kontrolluar, sipas linjës së drejtimit në cilësinë e zëvendësdrjtuesit, 4202 kallëzime penale të mosfilluara dhe 9996 procedime penale, në total 14198 çështje, një numër relativisht i lartë i çështjeve, çka tregon se ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Z. Erion Pano kryen veprime procedurale hetimore, të cilat rezultojnë të jenë produktive, duke iu referuar dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje, të cilat tregojnë aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve.

<sup>147</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2022.

<sup>148</sup>Dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2022.



## **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

294. Nga aktet e vëzhguara ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale. Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit, si dhe nuk ka të dhëna për përdorim të gjuhës diskriminuese që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

## **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

295. Nga dosjet e vëzhguara vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Prokurori Erion Pano, në detyrën e zëvendës/drejtuës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka shfaqur aftësi të mira në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar. Nga vlerësimet e punës së subjektit për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

## **Denoncimet nga publiku**

296. Për subjektin e rivlerësimit Erion Pano janë depozituar në total 3 denoncime nga publiku. Nga analizimi i denoncimeve, në një prej tyre nuk u evidentuan problematika, pasi nuk ishte objekt shqyrtimi nga Komisioni dhe nuk përmbante fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me pikën 2 të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **Lidhur me denoncimin e shtetasit S.Ç me nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2019<sup>149</sup>**

297. Ky shtetas pretendon se prej disa vitesh është sorollatur nëpër prokurori dhe gjykata, pasi prokurorët nuk zbatojnë ligjin i cili i ngarkon të ushtrojnë ndjekjen penale, të kontrollojë hetimet dhe të drejtojnë policinë gjyqësore. Denoncuesi ka kryer kallëzim penal ndaj shtetasit T.M me të cilën bashkëjetonte, me pretendimin se kjo e fundit, duke shpërdoruar besimin e tij, përmes mashtrimit i ka vjedhur një sasi të konsiderueshme të hollash. Sipas denoncuesit dalin qartë veprat penale dhe personat konkretë që i kanë kryer, por prokurorët, me qëllim favorizimin e personave fajtorë, kanë vendosur mosfillimin e procedimit penal, pa bërë asnjë verifikim apo hetim të plotë. Denoncuesi ka depozituar dy vendime gjyqësore<sup>150</sup>, të cilat kanë shfuqizuar vendimet e prokurorëve.

298. Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>151</sup> kopje të fashikullit të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 10.4.2018, ku nga përmbajtja e akteve ka rezultuar se ky material kallëzues është hetuar fillimisht nga një tjetër prokuror, i cili në datën 7.3.2017 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit Tiranë<sup>152</sup> në datën 13.3.2018, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve me detyra konkrete për organin e akuzës. Në zbatim të urdhërimeve të gjykatës është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë 10.4.2018, për veprën penale “mashtrim”,

<sup>149</sup>Ky denoncues ka bërë ankim me të njëjtin objekt edhe në Prokurorinë e Përgjithshme, evidentuar më sipër tek të dhënat arkivore.

<sup>150</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 23.5.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimi nr. \*\*\*, datë 16.7.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>151</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2022.

<sup>152</sup>Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.3.2018, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. \*\*, datë 13.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesës. Shfuqizimin e vendimit të prokurorit, datë 7.3.2017, për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin kallëzues nr. \*\* të vitit 2017 dhe dërgimin e akteve këtij organi për vazhdimin e hetimeve”.

parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, ku hetimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje ka vijuar nga prokurori Erion Pano, i caktuar me shortin e datës 27.4.2018.

299. Në përfundim të hetimit, subjekti ka kërkuar pushimin e çështjes (akti nuk përmban datë, por shkresa përcjellëse mban datën 19.2.2019), kërkesë e cila nuk është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>153</sup> dhe Gjykata e Apelit Tiranë<sup>154</sup>, pasi hetimet janë të paplota, duke urdhëruar kryerjen e hetimeve të mëtejshme brenda një afati 3-mujor. Nga aktet në dosje rezulton se veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata janë kryer në vijim nga një prokuror tjetër, i cili ka zëvendësuar subjektin Erion Pano me vendimin datë 2.3.2020 dhe në përfundim të hetimit, në datën 29.9.2020 ka kërkuar pushimin e çështjes, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\* regj. them., datë 11.2.2021.

### **Konstatime të Komisionit**

300. Nga verifikimi i dosjes penale Komisioni ka konstatuar:

- Zvarritje dhe mungesë të veprimeve hetimore<sup>155</sup> të deleguara nga subjekti pranë OPGJ-së.
- Subjekti ka disponuar me vendim për pushimin e çështjes, duke mos kryer një hetim të plotë të çështjes dhe duke mos zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara nga Gjykata e Apelit Tiranë, konkretisht nga 12 dëshmitarë janë pyetur vetëm 6 prej tyre, nuk është kryer ballafaqimi i kallëzuesit me të kallëzuarën dhe nuk janë pyetur persona që kanë dijeni për rrethanat e çështjes.

301. Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Shpjegimet e subjektit**

302. Në prapësimet e depozituara në datën 16.11.2022, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se në zbatim të vendimit gjyqësor ka deleguar kryerjen e veprimeve hetimore tek policia gjyqësore në datën 2.5.2018, ku janë kryer një sërë veprimesh procedurale, si dhe administruar praktika dokumentare. Subjekti shpjegon se pasi është njohur me veprimet e realizuara nga policia gjyqësore (për një periudhë 7-mujore, muaji gusht lejet e zakonshme), duke çmuar provat, si dhe fuqinë provuese të tyre, ka krijuar bindjen e plotë se çdo veprim tjetër hetimor nuk do të sillte asnjë risi për çështjen.

303. Lidhur me konstatimin e Komisionit se nuk është kryer ballafaqimi i kallëzuesit me të kallëzuarën, subjekti ka shpjeguar se është mbështetur në bindjen e tij të brendshme si pjesë e vendimmarrjes së tij, me argumentin se veprimi procedural i ballafaqimit ishte ezauruar në kohë (përmes procesverbalit datë 1.3.2017), ku secili nga palët u është përmbajtur pretendimeve të tyre. Gjithashtu, kallëzuesi dhe e kallëzuara kanë mbajtur po të njëjtin qëndrim kur janë pyetur përkatësisht në datat 8.6.2018 dhe 20.6.2018 (datat në procesverbal kanë gabim material, shkruhet viti 2017, por nga përmbajtja kuptohet lehtësisht që është 2018), duke krijuar bindjen se ballafaqimi i këtyre personave nuk do të sillte asnjë risi për çështjen, dhe kështu ka ndodhur, pasi personat kur janë ftuar për t'u ballafuar (siç evidentohet në procesverbalin përkatës datë 3.9.2020) u janë përmbajtur qëndrimeve të dhëna më parë, pa dhënë asnjë element shtesë.

<sup>153</sup>Vendimi nr. \*\*\* regj. them., datë 23.5.2019.

<sup>154</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 5.11.2019.

<sup>155</sup>Nga muaji maj 2018 deri në janar 2019 dhe nga muaji nëntor 2019 deri në mars 2020.

304. Subjekti ka shpjeguar se ka analizuar dhe interpretuar vlerën provuese të provave, si dhe ka argumentuar shkaqet ligjore ku është mbështetur për pushimin e çështjes, pasi nuk plotësohen elementet kryesore të anës subjektive dhe objektive. Subjekti ka çmuar se kryerja e veprimeve të tjera hetimore, përfshirë edhe atyre të orientuara nga gjykata, nuk do të sillnin asnjë argument të shtuar i cili do të ndikonte në arsyetimin e kërkesës për pushim. Më tej, subjekti ka prapësuar se gjykata, në vendimin e saj nr. \*\*\* regj. them., datë 23.5.2019, është mjaftuar vetëm me faktin e moskryerjes se të gjitha veprimeve të lëna nga gjykata, duke mos marrë në konsideratë se ishin kryer një sërë veprimesh procedurale dhe në asnjë moment nuk ndalet për të arsyetuar nëse argumentet e kërkesës për pushim janë të qenësishme apo jo. Sipas subjektit, nëse një gjë e tillë do të kishte ndodhur gjykata do të kishte një tjetër vendimmarrje asokohe, e më konkretisht atë të dhënë në datën 11.2.2021, ku është pranuar kërkesa për pushim.

305. Subjekti, në prapësime, shpjegon se prokurori tjetër i cili është ngarkuar për hetimin e mëtejshëm të çështjes ka kërkuar pushimin e çështjes në datën 29.9.2020, ku në pjesën arsyetuese ka argumentuar të njëjta shkaqe ligjore si ato të përmendura nga subjekti në vitin 2019. Rezulton që kërkesa për pushim të jetë pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjiqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* regj. them., datë 11.2.2021 (subjekti ka depozituar një kopje të këtij vendimi), ku nuk rezulton të jetë kryer një arsyetim ligjor i tillë që do të mund të hidhte dritë mbi ekzistencën e shkakut determinant që ka bindur gjykatën të japë një vendim ndryshe nga ai i dhënë më parë. Ndër të tjera, subjekti bën me dije faktin se sipas vendimit gjyqësor mosmarrëveshjet midis palëve ishin zgjidhur dhe kallëzuesi nuk kishte asnjë pretendim.

### **Vlerësimi i Komisionit**

306. Trupi gjykues, në analizë të akteve të administruara në fashikullin hetimor dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk ka respektuar urdhërimet e gjykatës, ku në zbatim të nenit 329/3/b të Kodit të Procedurës Penale, gjykata, jo vetëm që ka çmuar se hetimet janë të paplota, por ka përcaktuar edhe drejtimit e thellimit të hetimit, si dhe veprimet që duhet të kryhen për çështjen në fjalë.

307. Komisioni çmon se argumenti i subjektit se moskryerja e veprimeve hetimore është bazuar në bindjen e tij të brendshme dhe kryerja e tyre nuk do të sillte asnjë risi për çështjen, jo vetëm që nuk qëndron, por edhe paragjykon hetimin e çështjes dhe vlerësimin e saj, në përputhje me faktet dhe provat që i përkasin çështjes. Megjithatë, Komisioni vlerëson se ndonëse janë konstatuar mangësi në veprimet hetimore të ndërmarra nga prokurori Erion Pano, kjo rrethanë çmohet e pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me aftësi profesionale nën nivelin minimal të kërkuar nga germa “c” e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

**308. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2019, i shtetases A.S.** Kjo shtetase ka paraqitur ankim ndaj disa prokurorëve, midis të cilëve edhe subjekti Erion Pano, me pretendimin se prokurori në mënyrë të njëanshme, të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin nuk e filloi procedimin penal, në një kohë që denoncuesja kishte paraqitur prova konkrete për kallëzimin e saj.

309. Gjithashtu, denoncuesja pretendon se prokurorit i është kthyer dosja nga gjykata për hetime të mëtejshme, me detyra konkrete, por ky i fundit, pa i vazhduar hetimet, ia ka dorëzuar dosjen një prokuroreje tjetër pa e vënë në dijeni viktimën/kallëzuesen.

310. Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>156</sup> kopje të dosjes penale, ku nga përmbajtja e akteve rezulton se për këtë material kallëzues në datën 11.4.2018 subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti i kallëzuar nuk përbën veprë penale. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\*\* regj. them., datë 18.5.2018, e cila ka konsideruar të gabuar arsyetimin e prokurorit për mosfillim të procedimit, duke urdhëruar kryerjen e hetimeve me detyra konkrete.

311. Në zbatim të vendimit gjyqësor, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 6.6.2018 dhe në datën 7.6.2018 ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore. Në vijim, në datën 11.10.2018 subjekti ka sugjeruar bashkimin e çështjes me procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2017, hetimet e të cilit drejtohen nga prokurorja A.N (me kallëzues D.B ndaj shtetasve A.S), nisur nga fakti se objekti i kallëzimit ishte i njëjtë për veprën penale të mashtrimit<sup>157</sup>. Veprimet hetimore janë vazhduar më tej nga një tjetër prokuror.

### **Konstatime të Komisionit**

312. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti nuk ka vazhduar hetimet në kundërshtim me vendimin e gjykatës, si dhe nuk janë kryer veprime hetimore nga subjekti dhe as nga oficeri i policisë gjyqësore.

313. Në lidhje me këtë konstatim subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Shpjegime të subjektit të rivlerësimit**

314. Përmes prapësimeve të tij, subjekti ka parashtruar edhe një herë faktet dhe rrethanat e çështjes penale, ku, ndër të tjera, ka shpjeguar se në zbatim të vendimit gjyqësor ka deleguar kryerjen e veprimeve hetimore nga policia gjyqësore, në mbështetje të neneve 30 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale.

315. Sipas subjektit, në funksion të hetimit të çështjes, policia gjyqësore kishte proceduar me pyetjen e denoncueses A.S, administrimin e praktikave e dokumenteve, si dhe kishte nisur procedurën e njoftimit të shtetasve A. S dhe Sh. I, me qëllim pyetjen e tyre me cilësinë e personave nën hetim. Subjekti ka shpjeguar se në këtë fazë të hetimit, ka marrë dijeni se në ngarkim të të njëjtëve persona dhe për të njëjtin fakt ishin duke u zhvilluar hetime nga një tjetër prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.<sup>158</sup> Sipas subjektit, pas komunikimit me prokurorin i cili drejtonte hetimet në këtë rast (në funksion të procedimit penal tjetër nr. \*\*\*), në regjistrin e njoftimit të veprave penale ishin regjistruar emrat e shtetasve A. S dhe Sh. I, si persona nën hetim, për veprën penale “mashtrim”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, si dhe ishte kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”.

316. Në këto kushte, ndodhur para kritereve ndaluese procedurale ku nuk mund të realizoheshin hetime paralele, bazuar në nenet 29 dhe 79 të Kodit Procedurës Penale është vendosur bashkimi i procedimeve<sup>159</sup>, në rastin konkret procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2018 është bashkuar me atë nr. \*\*\* të vitit 2017.

<sup>156</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2022.

<sup>157</sup>Me vendimin datë 14.11.2018 është vendosur bashkimi i dy procedimeve penale në një të vetëm.

<sup>158</sup>Informacion për procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2018.

<sup>159</sup>Vendim për bashkimin e procedimeve, datë 14.11.2018.

317. Lidhur me pretendimet e denoncueses se veprimet hetimore nuk janë kryer të plota, subjekti ka shpjeguar se ky pretendim nuk qëndron, pasi sa më lart u përmend, ato janë realizuar në mbështetje të dispozitave ligjore dhe si rezultat i bashkërendimit të punës mes prokurorëve, personat janë marrë të pandehur dhe çështja penale në ngarkim të tyre është dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>160</sup>.

318. Në këtë rast nuk mund të flitet për cenim të besimit të publikut te drejtësia, pasi prokurori ka pasur marrëdhënie procedurale me çështjen penale konkrete deri në datën kur ka rënë në dijeni të faktit që hetimet po zhvilloheshin paralelisht nga një prokuror tjetër.

319. Subjekti ka argumentuar se bashkimi i procedimeve është mjet procedural i cili, kur krijohen kushtet ligjore, kthehet në një detyrim për organin procedues dhe ky mjet procedural ka rëndësi, pasi duke u mbledhur të gjitha faktet krijohet një tablo më e qartë rreth çështjes konkrete e personalitetit të të pandehurve. Më tej, subjekti ka shpjeguar se prokurori pasardhës ka dërguar çështjen për gjykim në gjykatë, e cila ka vlerësuar gjendjen e akteve dhe ka proceduar me kalimin për gjykim, çka do të thotë që ka pranuar sipas ligjit edhe veprimet procedurale të subjektit.

### **Vlerësimi i Komisionit**

320. Trupi gjykues i ka vlerësuar bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësime, sipas të cilit, i ndodhur para kriterëve ndaluese procedurale ku nuk mund të kryheshin hetime paralele, bazuar në nenet 29 dhe 79 të Kodit Procedurës Penale, prokurori Erion Pano ka vendosur bashkimin e procedimeve, në rastin konkret procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2018 është bashkuar me atë me nr. \*\*\* të vitit 2017, procedim ky i regjistruar me parë për dy persona të marrë nën hetim, për veprën penale “mashtim”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, si dhe ishte kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”.

### **Konkluzion mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

321. Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e prokurorit Erion Pano dhe sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “i aftë”.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Erion Pano ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

<sup>160</sup>Kërkesë nr. \*\*\*, viti 2017, për dërgimin në gjyq të çështjes (për më shumë referohuni fashikullit hetimor nr. \*\*\*)

- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Erion Pano, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 24.11.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
Kryesuese

**Suela ZHEGU**  
Relatore

**Brunilda BEKTESHI**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*